However, one needs not to mix the term of e-learning with e-University and online higher education. The reason is that e-learning means ‘E-learning may be seen as the latest version of attempts to increase learning opportunities by replacing academic staff with technology’ (Roscoe, 2007). The other two education system has academic staff to teach, but in the e-learning, academic staff is replaced by technology.

In short, it clear that human being and educators continue to find new teaching ways in order to improve education and teaching in higher educations. As we all accept that we are now in the age of technology.

### **3-British e-University Experiment**

In order to understand the question, we need to go back to 1997 and onward, and try to see what kind of developments were taking place in the UK’s higher education. Initially, the Labour Party came to power by saying ‘Education, Education, Education’ (Hill, 2002 ) in 1997 as a part of their election manifestation. The UK Secretary of State for Education, David Blunkett announced the launch of a ‘UK e-University’, proposing collaboration between top universities (Davis, 2003). In other words, the Labour government wanted to improve not only primary and secondary education but also higher education. So this e-University proposal was one of important turning points in their educational pledge. In order to understand more clearly, one needs to look at Blunkett speech on 19 July 1999. According to the BBC, ‘Mr Blunkett identified four key policy areas - modernising the comprehensive system, raising standards, developing pre-school education and promoting social inclusion’ (BBC, 1999). In here, e-University might have been part of the ‘modernising the comprehensive system, raising standards and promoting social inclusion’. In other words, everyone who wants to continue their further and higher education become able to enrol in the e-university which would be modern, place and time are not necessary. Further,

thousands, even hundred thousand would be able to enrol in this type of university without any 'elitist' selection.

### **a-A Pilot Project for a UK e-university**

There was a great belief that e-learning, e-University and online higher education would be the future. None wants to miss this opportunity. In addition, it is important to remember that there were developments on this issue in somewhere else. For example, as Hill and other state:

Pearsons publishers teamed up with an American virtual university and Henley Management College formed a virtual university partnership with the accountants and consultants Ernst & Young Overseas, Phoenix University was launched as a private e-University in the USA generating \$12 800 000 from on-line and distance learning courses.

Consequently, this initial project were seen a very important turning point in British higher education history. Then, 'it was envisaged as a way for the UK higher education institutions to enter large-scale online delivery, penetrate overseas markets and offer more learning flexibility for domestic students. The UK government initially committed £62 million (this figure was later adjusted to £55 million) to the project, with the expectation that investment from the private sector would also be elicited' (The Observatory on Borderless Higher Education, 2005). In this statement, it is clear that the government wanted the UK higher education institutions to 'penetrate overseas markets and offer more learning flexibility for domestic students'. Thirdly the government wanted to bring in the private sector in to this new business initiative as well.

UKeU 'was a private company (with around fifty staff), majority owned by the U.K. higher education sector. It did not award its own degrees, instead contracting with U.K universities to offer theirs. The company focused on infrastructure development, course development support, quality assurance, and marketing. The target audiences were primarily (1) international graduate students who wished to study online rather than come to the UK and (2) the private business sector (businesses wanting customized degree-level training for staff, for example)' (Garrett, 2004, p. 4).

According to another source, UKeU has business managers in nine countries and has 26 local partners in 16 countries who help market its degrees and provide premises and support for students. By November last year 16 UK universities were offering courses via UKeU, mainly in business and management, environmental studies, science and technology. But universities complained privately that UKeU was charging too much for retailing their degrees abroad when they were developing the courses themselves. These complaints, and the evidence that pure undiluted online learning doesn't work except for the most committed students, have prompted a Hefce's change of direction (MacLeod, 2004 ).

What has happened? I assume that the following statement tell the history/story of this new business opportunity and a pilot of e-University project.

The first online courses were launched in March 2003, and by November 900 students had been recruited. However, with predicted enrolment figures of one million students by UKeU's tenth year of operation, actual student take-up proved disappointing. In addition, private investment, seen as a key feature of UKeU's business model had not been secured. As a consequence, the Higher Education Funding Council for England, which had administered the funding on behalf of the government labelled UKeU unviable in April 2004 and closed the venture (The Observatory on Borderless Higher Education, 2005).

The expectations and prediction basically were not met, and then the best decision on the project made by the HEFCE after exactly four year later of the project had started that is to stop all activities of the project.

### **b-The Reasons to Halt the Project**

According to the Guardian news paper,

The venture launched in 2000 at the height of the dotcom boom by the then education secretary, David Blunkett, as a worldwide 21st century successor to the Open University. As a series of universities around the world have discovered, there is less demand for online study than enthusiasts predicted and UKeU looks like becoming the latest to get its fingers burned financially by investing in online learning. Instead of selling online degrees abroad, the aim will now be to use what remains of the taxpayers' funding to support e-learning programmes at individual universities and colleges for home and overseas students. The funding council said that universities were more interested in "blended" learning involving a mixture of IT, traditional, work-based and distance learning to meet the diverse needs of students - rather than concentrating on wholly e-based learning. (MacLeod, 2004 ).

Consequently, it has been said that the expectations and predictions of the project were not met in the prescribed time scale. This is quite obvious reason. However, in this heading, the article tries to articulate whether the government had done everything to bring this project into life or was there any other reasons. In other words, as it was stated in the one of the parliament reports. The UK e-University project was effectively wound up last year by HEFCE, having spent £50 million of public money but having succeeded only in attracting 900 students. We inquired into the issue to find out why this had happened, what lessons could be learnt from the failure of the project, and to consider the future for e-learning and e-Universities in the UK (HC 205 , 2005 ).

So this paper to some extent investigates this report and tries to highlight important points which had been raised.

Firstly, the report states that 'it took a supply-driven rather than demand led approach' (HC 205 , 2005 , p. 3). In here, we understand that there was no demand for this new product in the country and the initiative had to create demand while it was supplying the goods. Secondly, the report also puts stress on another important market term which is 'an inability to work in effective partnership with the private sector' (HC 205 , 2005 , p. 3). In other words, the private sectors initially had not been convinced about the goods as well as possible outcome of the market. These two initial statements are clearly mistake and inability of the government (who run the project). In addition their inability, the project managers had been awarded of 'bonuses to senior executives of UK e-U' (HC 205 , 2005

, p. 3). This drawn public attention and had been complained. Despite, this ‘bonus scheme and potential share packages are examples of the anomalies that were caused by the fact that the structure and systems were set up under the assumption that private investment would be part of the project’ (HC 205 , 2005 , p. 3). It seems that the managers started with a wrong doing which would have been very much depend on the partnership and incomes. It can be argued that as the report states ‘for either the private sector or the public sector the bonuses paid to senior staff were wholly unacceptable and morally indefensible’ (HC 205 , 2005 , pp. 3-4) and psychologically aimed at killing the project.

It is worth to state another reason which I fully agree with as stated ‘confusing existed between the mainstream U.K. education brand emphasizing the three elements of tradition, place, and quality and marking by UKeU that promised “the best of U.K. higher education with online convenience” without being able to utilize these elements’ (Garrett, 2004, p. 4). In the reports, there is other information why this project fails. Some of them are detailed explanation of the above mentioned points. Further points raised in the report are as follow: a- issues around the general operation of the venture (covering recommendations 2-11, 13, 14, 24-26);

b-ccountability issues(primarily recommendations 12, 15-23);  
relating to UKeU structure;

b.1- relating to HEFCE;

b.2- relating to DfES;

b.3-the way ahead on e-learning(recommendations 27-32) (HC 205 , 2005 , p. 1).

It seems that there is no need to look at these areas in detail, because the report and the government’s respond to this report already have highlighted. However, for the purpose of this study, it is much better to look at what lessons have been drawn from this experience.

### **c-Lessons Learned**

It is important to note that there are many lessons drawn from this experience in term of e-University as well as e-learning and other internet related learning activities in the higher education of the UK and other part of the World.

The first lesson is that ‘dotcom’ ventures and related markets had changed dramatically within very short time. In the beginning of the year 1997 till 1999, there was a kind of ‘e-business mania’ (Pidduck, 2000) which had been consumed about a few years and many e-business companies had liquidated. During this period, the government announced the e-University project in 2000 and the actual activity took place in 2003 when nearly e-business companies were about disappearing. ‘Similarly, eLearning has taken a different course than the venture anticipated, with greater focus on eLearning blended with elements of campus-based or distance learning, rather than wholly Internet-based learning’ (HC 489, 18 October 2005, p. 3). When these two came together, there was no other option rather than failing.

There was a good example in the US in this kind of venture which relies on two important reasons, namely ‘the dot-com boom presented online delivery as an alternative to the conventional campus rather than as a supplemented, as has more often turned out to be the case. ...online delivery outside the United States has (with key exceptions) yet to attain

sufficient status, scale, and sophistication to succeed' (Garrett, 2004, p. 4). These inform that it is not quite easier to run e-University, if there is no good 'online delivery' system which links the e-University to the potential customers.

The second lesson is 'the public sector should not shrink from high risk projects' (HC 489, 18 October 2005, p. 4). The reason is very obvious that the public sector does not act as quick as the private sector if there is a high risk in any business activities. The losses of the public sector in this kind of high risk venture is always higher than the private sector if one needs to compare with them. This is explained in the report as 'senior management should have had either very clear accountability for the expenditure of public money, or risk from market pressures to succeed through private investment in the project' (HC 205, 2005, p. 25). This could be avoided if the e-University 'was to be jointly funded by public and private investment in equal shares, there was an accountability structure and framework intended to protect public funds' (HC 489, 18 October 2005, p. 5).

The third lesson is that importance for 'high quality advice to be available to an accounting officer. It is necessary to be able to understand what a delivery agent is doing and to be able to mount effective and appropriate challenges where necessary, while avoiding duplication of effort' (HC 489, 18 October 2005, p. 6). In contrast, the government did not agree with the recommendation of the report. It seems that this type of request is important in order to protect the wrong usage of the public money. The fourth lesson is that people who would manage the e-University project were not specialised to run this project.

Finally, it is clear that this project initially thought a private business venture which had to be run by bureaucrats. It was wrong. Any private business venture should be run by private companies within the market rules in order to be successful.

#### **d-There were some recommendations**

The recommendations are all about how any government or any department of the government should continue their role in this sector. These are as follow:

- The Government must deliver on its commitment to outline its strategy, and action plan for its implementation, for embedding e-learning in HE in a full and sustainable way;
- The Government, through HEFCE, ensures that thorough and robust market research is undertaken for use by the whole sector in order to maintain the UK interests in the global market for e-learning, keeping in mind the commercial sensitivity of such research, and the potential for collaborative projects between FE and HE sectors;
- We recommend that the Government, through HEFCE, clarifies how it intends to invest in and support collaborative ventures in e-learning both across the HE sector, and between the FE and HE sector, in a way that provides equal opportunity and advantage to all those who would wish to be involved in the global market for e-learning;
- The Government, through HEFCE, must clarify its national strategy for developing e-learning in the UK and how it intends to invest in and support e-learning across the HE sector in a way that provides coherent progress (HC 205, 2005, pp. 31-38).

## **e-Conclusion**

It seems that this experience gives clear information why the UK e-University project failed. The demand of market is very important for any kind of business venture including education. Further, there is a great risk, if someone tries to create supply without the demand. Secondly, technological development in communication technology and computer is important and significant. 'E-learning has a vital and exciting role to play in higher education because it empowers learners, enables teaching to be more creative and innovative, and enables students to develop skills of value in the workplace' (MacLeod, 2004 ). However, there are huge amount of areas where is not clearly visible for many. This gray areas of the technology needs to be more visible in order to set up a business venture. However, every day there is a growing amount of e-learning and online courses in the higher education around the world. Still there is no clear data available how much these kind of education successful if one compares with the traditional higher educational delivery.

The HEFCE statement said that 'Much has been learnt through the e-Universities project - both by the company, and by the participating universities and colleges and students. It is essential to capitalise on this experience as higher education institutions further develop their e-learning programmes. The project has also provided many important lessons about the potential use of new technologies in higher education' (MacLeod, 2004 ). Finally, there are still a long way to go before implementing e-university, e-learning as well as online higher educational programmes.



## References

Bacsich, P. (2004). Introduction to Virtual University and e-Universities. The e-University Compendium .

BBC. (1999 , July 19). Education Blunkett attacks ‘elitist’ critics . Retrieved June 21, 2012, from BBC Online Network: [http://news.bbc.co.uk/2/hi/uk\\_news/education/396338.stm](http://news.bbc.co.uk/2/hi/uk_news/education/396338.stm)

Davis, E. B. (2003). Building on Solid Foundations: establishing criteria for e-learning development. Ashridge Business School UK - <http://www.ashridge.org.uk> , 27 (3) , 227-245. Journal of Further and Higher Education.

Garrett, R. (2004). The Real Story Behind the Failure of U.K. eUniversity. Educause Quarterly, Number 4 , 4-6.

HC 205 . (2005 ). UK e–University: Third Report of Session 2004–05. London: The House of Commons .

HC 489. (18 October 2005). UK e-University: Government’s Response to the Committee’s Third Report of Session 2004–05 . London: The Stationery Office Limited.

Hill, D. (2002 , October 10). “Education, Education, Education”, or “Business, Business, Business”? The Third Way ideology of New Labour’s educational policy in England and Wales . Retrieved June 20, 2012, from Education-line Home Page : <http://www.leeds.ac.uk/educol/documents/00002208.htm>

Kaplan University Online. (2001 - 2012). Kaplan University Online . Retrieved June 20, 2012, from Kaplan University Online : <http://www.excite.com/education/kaplan-university-online>

MacLeod, D. (2004 , March 4). Hefce pulls the plug on UK e-university. Retrieved June 21, 2012, from [guardian.co.uk](http://www.guardian.co.uk);<http://www.guardian.co.uk/technology/2004/mar/04/highereducation.universityfunding>

Online Education.org. (2012). What Is Online Higher Education? Retrieved June 20, 2012, from Online Education.org: <http://www.onlineeducation.org/higher-education-online>

Pidduck, A. B. (2000). e-Business: Discussion with UW Students. CS 798L Topics in Electronic Commerce . Waterloo University.

Roscoe, J. (2007). The language of e-learning . The Higher Education Academy.

The Observatory on Borderless Higher Education. (2005, December ). The UK e-University:

An Overview of Available Resources. Retrieved June 20, 2012, from The Observatory on Borderless Higher Education: [http://www.obhe.ac.uk/what\\_we\\_do/key\\_resource\\_dec\\_2005\\_uk\\_euniversity](http://www.obhe.ac.uk/what_we_do/key_resource_dec_2005_uk_euniversity)

## The internal evaluation process of the universities a key need for quality assurance in Higher Education– Model of European University of Tirana

### Abstract

*The European Standards and Guidelines provide the framework for the national quality assurance systems in three axes: (i) Internal quality assurance, (ii) External quality assurance, (iii) External quality assurance agencies.*

*Internal quality assurance from the Bologna perspective stressed that “the primary responsibility for quality assurance in higher education lies with each institution itself”.*

*In Albania is established the Albanian Public Agency for Accreditation of Higher Education. This agency is responsible for the external evaluation of the public and private Institutions of Higher Education in Albania.*

*The European University of Tirana has successful accomplished both internal and external evaluations for the accreditation of itself, as institution, and of all current Study Programs. Now EUT is an accredited university.*

*This paper will present how EUT has accomplished its internal evaluation for more than three times over six years. The main focus of this paper is to present the internal evaluation in EUT as a participatory and inclusive process, based on a real consolidated quality assurance system, equipped with its principles, structures, mechanisms, instruments, procedures and criteria. This experience can be a good example/model for other institutions of higher education in Albania.*

**Keywords:** *Quality assurance, Higher Education, Process, Structures, System, Procedures, Instruments, Standards.*

## 1-Hyrja:

Çështja e cilësisë dhe e forcimit të saj është një problem tashmë i shtruar për shumë sektorë të jetës, si në ekonomi, biznes, bujqësi, administratë, marketing, sistemin e shërbimeve etj. Në literaturën përkatëse të ekspertëve që hulumtojnë mbi çështjet që lidhen me cilësinë (pavarësisht nga fushat) ka një debat ende të gjallë mbi konceptin dhe definicionin e cilësisë.

Veçanërisht në arsimin e lartë, shumë stakeholders e kanë të vështirë të përcaktojnë saktë definicionin mbi cilësinë. Në fakt duhet pranuar se ky është një koncept relativ që ka domethënie të ndryshme për njerëz të ndryshëm. Për shembull, ndërsa flasin për cilësi në një institucion të arsimit të lartë, studentët mund të fokusohen në fasilitetet e ofruara dhe në dobinë e arsimimit për punësim në të ardhmen. Nga ana tjetër stafi akademik mund t'i japë rëndësi procesit të mësim-dhënies. Menaxhimi mund të jetë më i fokusuar tek arritjet administrative dhe menaxheriale të institucionit. Prindërit mund të konsiderojnë arritjet e fëmijëve të tyre. Ndërsa punëdhënësit mund të marrin në konsideratë kompetencën e të diplomuarve. Pra çdo grup interesi ka një qasje të ndryshme për të definuar konceptin cilësi. Ajo që mund të kuptohet nga këto shembuj është konkluzioni se është e pamundur të flitet për cilësinë si një koncept i vetëm.

Çdo përcaktim i cilësisë duhet të definohet në përputhje me kontekstin në të cilin ajo përdoret. Duke konsideruar këtë fakt Green ka listuar pesë qasje të ndryshme për cilësinë në fushën e arsimit të lartë. Sipas saj ky koncept mund të shihet:

- Në kuptimin e përjashtimit (standardet më të larta)
- Në kuptimin e përshtatshmërisë ndaj standardeve
- Si përshtatje ndaj qëllimit
- Si efektivitet në arritjen e qëllimeve institucionale
- Si plotësim i nevojave të shpallura ose të nënkuptuara të klientit (Green. 1994)

Globalizimi ka ndikuar në arsimin e lartë dhe ka bërë që ai të ndeshet me një sërë sfidash. Dirk Van Damme, është i mendimit se ndoshta sfida më e rëndësishme për arsimin e lartë në shekullin XXI është zhvillimi i një qasjeje ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë dhe akreditimin. Sipas tij në këtë drejtim duhen ndërmarrë disa hapa, ndër të cilat i pari është rënia dakord për një set definicionesh dhe për një fjalor konceptesh në lidhje me sigurimin ndërkombëtar të cilësisë dhe akreditimit (Van Damme, Dirk Gehnt University. 2001). Mbështetur në këtë rekomandim u shfaqen dy shtyllat kryesore konceptuale të procesit të sigurimit të cilësisë:

1. Sigurimi i brendshëm dhe
2. Sigurimi i jashtëm.

Sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë janë si dy anët e të njëjtës medalje. Në dokumentet zyrtare të Bolonjës të dy këto aspekte janë shfaqur që në takimin e Berlinit të vitit 2001. Standardet dhe Udhëzimet Europiane dhe Regjistri European që pasojnë procesin e Bolonjës, përbëjnë hapat kryesore zbatuese për sigurimin e cilësisë.

Këto dokumente pasqyrojnë kornizën për sistemet kombëtare të sigurimit të brendshëm në tre akse kryesore:

1. Sigurimi i brendshëm i cilësisë
2. Sigurimi i jashtëm i cilësisë dhe
3. Agjencitë e sigurimit të jashtëm të cilësisë

Nga pikëpamja e procesit të Bolonjës, sigurimi i brendshëm i cilësisë thekson se: “duke qenë në përputhje me autonominë institucionale, përgjegjësia parësore për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë i përket çdo institucioni në vetvete dhe kjo pasqyron bazën për llogaridhënien reale të sistemit akademik brenda kornizës kombëtare të cilësisë” (Dionyssis. 2008). Ky koncept u theksua edhe në Komunikatën e Bergenit të vitit 2005, në të cilën u kërkuar që institucionet e arsimit të lartë të intensifikonin përpjekjet e tyre për cilësi të veprimtarive të tyre, duke ndërtuar mekanizma të brendshme, të cilat duhet të kenë korrelacion të drejtpërdrejtë me sigurimin e jashtëm të cilësisë (Dionyssis. 2008). Ky koncept u pasurua në Komunikatën e Londrës në vitin 2007 ku u theksua se meqenëse përgjegjësia kryesore për cilësinë u takon institucioneve të arsimit të lartë, ato duhet të zhvillojnë sistemet e tyre për sigurimin e cilësisë. Sfidat më të mëdha të institucioneve të arsimit të lartë u theksua krijimi i kulturës së cilësisë brenda komunitetit të tyre institucional (Dionyssis. 2008). Kultura e cilësisë i referohet një kulture organizative që synon të theksojë në vijimësi cilësinë dhe karakterizohet nga dy elementë të pastër: nga njëra anë një element kulturor/psikologjik të ndarjes së vlerave, besimeve, pritshmërive dhe përkushtimit ndaj cilësisë, dhe nga ana tjetër një element strukturor/menaxherial me procese të përcaktuara që thekson cilësinë dhe synon koordinimin e përpjekjeve individuale. (European University Association. 2006) Diskutimet e fundit mbi cilësinë dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë janë bërë kaq shumë unanime në drejtim të kërkesës për nxitjen e kulturës së cilësisë, sa që shpesh kultura e cilësisë konsiderohet si një sinonim për “zhvillimin e, dhe në pajtim me, proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë” (Harvey. 2009).

Në përputhje me këto orientime tashmë janë ndërtuar dhe pranuar Standardet dhe Udhëzimet Europiane, specifikisht për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Ato janë (Harvey. 2009):

- 1- Strategjia, politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm
- 2- Aprovimi, monitorimi dhe rishikimi periodik i programeve
- 3- Vlerësimi i studentëve
- 4- Sigurimi i cilësisë së stafit akademik
- 5- Burimet e të nxënies dhe mbështetja ndaj studentit
- 6- Sistemet e informimit
- 7- Informimi i publikut

Në Shqipëri tashmë është ngritur Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL). APAAL-i është një institucion shtetëror dhe publik, pjesë e Sistemit të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë në Shqipëri, në varësi administrative të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, e krijuar me vendim të KM nr. 303, datë 1.7.1999 “Për krijimin e sistemit të akreditimit në arsimin e lartë”. APAAL ka si mision kryesor të saj sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Për realizimin e misionit të vet APAAL-i mbështetet në disa parime themelore si respektimin e autonomisë institucionale dhe lirisë akademike të Institucioneve të Arsimit

të Lartë, transparencën dhe informimin në çdo hap të procesit, mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë në IAL, objektivizmin dhe profesionalizmin në të gjitha proceset e kryera prej saj si dhe në respektimin vetëm të kriterëve dhe standardeve shtetërore të cilësisë, të standardeve evropiane të cilësisë dhe në standartet akademike në AL. APAAL-i është përgjegjës për vlerësimin e jashtëm si të universiteteve publike, ashtu të atyre private. (APAAL. 2011)

Universiteti Europian i Tiranës (UET) ka realizuar me sukses disa vlerësime të brendshme dhe të jashtme, dhe aktualisht gëzon statusin e universitetit dhe është i akredituar si institucion dhe ka të akredituara të gjitha programet e studimit për të cilat ka lëshuar diploma.

Në UET i kushtohet një rëndësi e dorës së parë sigurimit të brendshëm të cilësisë. Sigurimi i brendshëm i cilësisë në UET shihet si një proces që shtrihet në dy plane:

1. Së pari në zbatimin me korrektesë të përgjegjësive sipas hierarkisë vendim-marrëse brenda universitetit, dhe
2. Së dyti si funksion i një entiteti të veçantë, të ngritur posaçërisht për këtë qëllim, të quajtur Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC)

Në rastin e UET nuk do të ndalem tek aspekti i parë, por në të dytin, duke u fokusuar tek sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë në UET dhe në misionin, funksionet, përbërjen dhe veprimtarinë e KSBC.

Në trajtimin e këtij komponenti do të mbështetem tek dokumentacioni themelor i UET, i cili përfshin Statutin e UET, Rregullores bazë të këtij institucioni, tek Broshura e dokumenteve në zbatim të Statutit dhe Rregulloreve bazë të UET, në formatet dhe formularët e miratuar si dhe në veprimtarinë konkrete të KSBC.

Neni 11 i Statutit të UET bën fjalë për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë (Statuti i Universitetit Privat UET. 2011). Në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë në pikën 11.1 shpallet: “Sigurimi i brendshëm i cilësisë është vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të UET-it. Ky vlerësim kryhet të paktën 1 (një) herë në 5 (pesë) vite, por gjithashtu mund të kryhet sa herë shihet e arsyeshme, si vlerësim i përgjithshëm ose i pjesshëm. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet nga vetë institucioni nëpërmjet:

1. Strukturave hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të UET-it, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij.
2. Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila vlerëson efikasitetin e veprimtarive akademike, administrative dhe financiare të universitetit dhe harton Raportin përkatës të Vlerësimit të Brendshëm – RVB. Ky raport diskutohet në të gjitha njësitë e UET-it, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen.

Në Rregulloren bazë të UET neni 7 i kushtohet specifikisht njësisë përgjegjëse për cilësinë Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ky nen thekson se KSBC është njësi autonome operative e përhershme në strukturën organizative të Universitetit. Komisioni

vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore, si dhe të veprimtarisë administrative e financiare të UET-it. Për ushtrimin e funksioneve të tij, KSBC-ja ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Komisioni përbëhet nga Kryetari si edhe nga anëtarë që përfaqësojnë çdo fakultet, personelin ndihmës – akademik ose administrativ, si dhe një anëtar përfaqësues nga Këshilli i Studentëve. (Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës. 2011)

Në Broshurën e dokumenteve në zbatim të Statutit dhe Rregulloreve të UET (Broshura e Dokumenteve në zbatim të rregulloreve, UET), një pikë e veçantë i kushtohet dy aspekteve të rëndësishme:

1. Sigurimit të brendshëm të cilësisë (SBC) dhe
2. Strukturave përgjegjëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë

Për SBC në këto dokumente përcaktohen parimet mbi të cilat ndërtohet SBC, qëllimet e SBC dhe objektivat e SBC. Parimet mbi të cilat ndërtohet Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë – SBC-së në UET janë:

1. Krijimi i një tabloje të qartë dhe reale rreth gjendjes aktuale të UET në momentin e dhënë;
2. Ngritja e sistemit të brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe krijimi i kulturës së cilësisë në institucion.
3. Garantimi i transparencës me qëllim informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerë për performancën e UET-it, njësisë të tij, programeve, kurrikulave, shërbimeve etj. Qëllimet e SBC-së janë:

1. Rritja e vazhdueshme e cilësisë së drejtimit të UET-it, nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave bashkëkohore, si edhe angazhimit të të gjitha niveleve drejtuese dhe organizative.
  2. Aplikimi i vazhdueshëm i filozofisë së UET-it, duke zbatuar një program akademik që përkon si nga ana konceptuale dhe kronologjikisht me synimet që ka UET-i.
  3. Rritja e vazhdueshme e cilësisë së formimit të studentëve, duke u ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat më bashkëkohore të mësimdhënies dhe duke nxitur të qenin proaktiv e kritik në dhënien e opinioneve mbi çështje aktuale.
- Objektivat e SBC-së janë:

1. Monitorimi i vazhdueshëm i drejtimit të institucionit.
2. Ndjekja e vazhdueshme e gjendjes së programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre, nëpërmjet krijimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së mekanizmave zyrtare për miratimin, vlerësimin periodik dhe për monitorimin e programeve dhe diplomave.
3. Ndjekja e vazhdueshme e nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës, si edhe kualifikimit të tij.
4. Monitorimi i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe i vlerësimit të studentëve dhe ruajtja e cilësisë së tij.
5. Ndjekja e vazhdueshme e ecurisë së kërkimit shkencor në institucion.
6. Monitorimi i nivelit të përfshirjes së studentëve në veprimtaritë e përditshme të

institucionit.

7. Ndjekja e ecurisë së bashkëpunimit të UET-it me institucione të tjera akademike dhe joakademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

8. Shtrirja e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në të gjitha hallkat organizative të institucionit.

Në lidhje me strukturat përgjegjëse për SBC në dokumentet bazë përcaktohen dy kategori strukturash:

- Strukturat hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të UET-it;
- Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – KSBC, nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive që ushtrohen në UET, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Për KSBC, në këto dokumente, përcaktohet përbërja e tij, kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të tij, funksioni i tij, si dhe marrëdhëniet e tij (dhe të UET-it) me APAAL-in.

KSBC-ja përbëhet nga Kryetari i Komisionit, një përfaqësues nga pedagogët e çdo Fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik, ose administrativ, një përfaqësues nga organizatat studentore si dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm.

Në përzgjedhjen e anëtarëve merren parasysh kriteret e mëposhtme:

1. Kompetencat profesionale;
2. Paanshmëria;
3. Mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin
4. Shkalla e nevojshme e njohjes të anëtarëve të Komisionit;
5. Të mos jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET-it.

KSBC vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore ose artistike, si dhe efikasitetin e veprimtarive administrative dhe financiare të institucionit. Ai përgatit Dosjen e Vetëvlerësimit, pjesë e së cilës është edhe Raporti i Vetëvlerësimit. KSBC-ja ka autonomi operative dhe akses në të dhënat e institucionit. Rezultatet e KSBC-së publikohen. Kryetari i KSBC-së merr pjesë rregullisht në mbledhjet e Rektoratit. KSBC-ja ndërton marrëdhënie bashkëpunimi me APAAL-in dhe, në bashkërendim me të harton një plan kontaktesh e vizitash në institucion. KSBC-ja krijon dhe mban në vijimësi marrëdhënie me institucione pjesëmarrëse në Rrjetin Europian të Sigurimit të Cilësisë, të cilat pas vendimit të Rektoratit, mund të ftohen të zhvillojnë kontrollin e jashtëm të UET-it. Për të garantuar zbatimin e kriterëve, procedurave dhe standardeve të vendosura, në UET janë hartuar një numër i konsiderueshëm formatesh e formularësh (mbi 50 të tillë), të cilët mbulojnë të gjitha veprimtaritë akademike, ndihmëse – mësimore dhe administrative të këtij institucioni dhe shtrihen në të tre ciklet e studimit.

Ato përfshijnë ndërtimin e programit të lëndës dhe indikatorët e vlerësimit të tij, hartimin e tezave të provimeve, detyrat e kursit, tutoriati, praktika profesionale, diplomat, fushat e ekspertizës së stafit akademik në funksion të udhëheqjeve të diplomave, plani individual dhe i integruar i punës kërkimore – shkencore të pedagogut, check-list për organizimin e veprimtarive kërkimore – shkencore, vlerësimi i veprimtarisë kërkimore – shkencore, përkthimet dhe redaktimet e botimeve të UET – PRESS, kërkesat dhe ankesat e studentëve,

pasurimi i literaturës së lëndës, kërkesa për leje, angazhimi i pedagogëve të huaj, vlerësimi i performancës së pedagogut (vetëvlerësim, vlerësim nga kolegu/eprori, vlerësim nga studentët), ngarkesa e pedagogut, realizimi i normës së çdo pedagogu etj. Siç u theksua edhe më lart, sigurimi i zbatimit të të gjithë këtij sistemi është detyrë përveç se e strukturave hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të UET-it, edhe e Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – KSBC.

KSBC në UET e ushtron këtë përgjegjësi nëpërmjet dy formave të kontrollit:

1. Vlerësimin të plotë të performancës së universitetit dhe  
2. Vlerësimin tematik të aspekteve të caktuara të veprimtarisë së Universitetit.  
Në UET Vlerësimi i plotë i brendshëm i performancës së universitetit është realizuar, ashtu sikurse e kërkon edhe kuadri ligjor, sa herë ka qenë e nevojshme për akreditimin, si institucion dhe të të gjitha programeve të studimit. Në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues, si dhe në zbatim të udhëzimeve të APAAL-it aspektet kryesore për vlerësimin e plotë të brendshëm të performancës së universitetit kanë qenë:

1. Misioni dhe Objektivat e Institucionit të Arsimit të Lartë (IAL), të një programi, të një kurrikule etj.
2. Struktura organizative e IAL, e njësisve përbërëse dhe menaxhimi i tij
3. Analiza e kurseve të studimit, diplomave Master etj.
4. Programet e studimit, organizimi i kurrikulave, marrëveshja e Bolonjës, kreditet
5. Stafi mësimdhënës dhe mbështetës
6. Mësimdhënia
7. Kërkimi shkencor
8. Studentët dhe pasuniversitarët
9. Fasilitetet, burimet materiale, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit
10. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare
11. Sistemi i brendshëm i Sigurimit të Cilësisë
12. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Secili nga këto aspekte shoqërohet qartazi me nën aspektet përkatëse. Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm është ndërtuar në përputhje të plotë me Treguesit e matshëm për vlerësimin e cilësisë në arsimin e lartë (APAAL.Udhëzues për vlerësimin e brendshëm të cilësisë në arsimin e lartë. 2005). KSBC deri tani ka realizuar 2 Raporte të plota të Vlerësimit të Brendshëm, njërin në vitin 2009 për akreditimin e UET institucionalisht dhe programet e nivelin Bachelor dhe një në vitin 2010 për akreditimin e programeve Master. KSBC ka përgatitur edhe Raportin e tretë të Vlerësimit të Brendshëm për akreditimin e programeve të reja qoftë në Bachelor, qoftë në Master.

Për përgatitjen e Raporteve të Vlerësimit të Brendshëm procesi ka kaluar në disa etapa: Së pari është organizuar një takim i veçantë mes KSBC-së dhe specialistëve të APAAL-it, takim i cili ka shërbyer për t'u njohur më specifikisht me afatet dhe detyrimet e procesit të vlerësimit. Për përgatitjen e Raportit të parë të Vlerësimit të brendshëm në UET (2009), është ngritur paraprakisht Grupi i Vetëvlerësimit. Funkzionimi i tij është kryer në përputhje me Udhëzimin e miratuar nga Senati Akademik i UET-it, më datë 02.03.2009: “Për organizimin dhe funksionimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe organizimit të sistemit të vlerësimit



të brendshëm” (Raporti i vlerësimit të brendshëm. 2009)

Në zbatim të këtij Udhëzimi, Grupi i Vetëvlerësimit u ngrit nën përgjegjësinë e Rektorit, pasi ky i fundit mori edhe mendimin e Senatit. Brenda grupit u përcaktuan detyrat dhe përgjegjësitë për çdo anëtar. Në Grupin e Vetëvlerësimit u përfshi edhe Kryetari i Këshillit Studentor.

Ashtu sikurse ishte paraparë dhe shprehur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të vitit 2009, Grupi i vetëvlerësimit u kthye më pas në një grup vlerësimi permanent dhe të institucionalizuar (sot KSBC). Në terma afatgjatë, përvoja e vlerësimit të brendshëm të vitit 2009 ka shërbyer si hap i rëndësishëm për të konsoliduar dhe forcuar Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në UET dhe instalimin e kulturës së cilësisë. Më pas Grupi i Vetëvlerësimit, (i quajtur më vonë KSBC), përgatiti Dosjen e Vetëvlerësimit, pjesë e së cilës ishte dhe Raporti i Vetëvlerësimit. Grupi i Vetëvlerësimit u trajnua nga stafi i APAAL-it dhe ju vunë në dispozicion materialet udhëzuese për vlerësimin, organizimin e grupit dhe të punës. Po ashtu u realizua edhe njohja me procesin, detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e secilit anëtar. Të gjitha Vetëvlerësimet janë kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në zbatim të udhëzimeve të dhëna nga APAAL-i. Grupi i Vetëvlerësimit ka qëndruar në kontakt të vazhdueshëm me përfaqësues dhe specialistë të APAAL-it. Produkt i këtij procesi të vetëvlerësimit është Dosja e Vetëvlerësimit, në përbërje të së cilës, vend qendror zë Raporti i Vetëvlerësimit, i cili në fazën e draftimit u konsultua me të gjithë stafin e UET-it. Në përbërje të Dosjes së Vetëvlerësimit janë përfshirë (Raport i Vetëvlerësimit”, UET 2009 dhe 2010):

- 1.Mendimi me shkrim i Rektorit;
- 2.Raporti i Vetëvlerësimit, i ndarë në dy pjesë:
  - 2.1 Pjesa e Parë: Pjesa analitike dhe përshkruese e Raportit
  - 2.2Pjesa e Dytë: Informacionet sasiore, sipas indikatorëve.
- 3.Dokumentacioni i kërkuar në mbështetje të vlerësimit

Gjatë gjithë procesit të përgatitjes së Raportit, Grupi i Vetëvlerësimit/KSBC ka pasur parasysh të përfshijë mendimet më të vyera të stafit akademik dhe atij ndihmës, si dhe të studentëve, çka ka shërbyer edhe si një fushatë informimi në lidhje me procesin e vlerësimit të brendshëm dhe pasqyrimin e tij në Raportin përkatës. Për mbledhjen e mendimeve të stafit dhe të studentëve janë organizuar takime formale dhe informale, ndërsa njohja përfundimtare me Raportin e Vetëvlerësimit është bërë në një takim të të gjithë njësisë, ku janë diskutuar të dhënat, mendimet, komentet dhe rekomandimet e shprehura në raport. Edhe në këtë fazë, Grupi i Vetëvlerësimit/KSBC ka qenë i hapur ndaj mendimeve të ndryshme dhe ka përfshirë në versionin përfundimtar të Raportit mendimet, sugjerimet apo komentet e argumentuara.

Raportet i Vetëvlerësimit shprehin në mënyrë të detajuar e reale situatën, ecurinë dhe problematikën e funksionimit të UET-it, me fokus programet e studimit përkatëse në situatën e dhënë. Aty analizohen dhe jepen me detaje të gjitha aspektet akademike, ligjore e organizative, duke filluar nga strategjia e objektivat e UET-it, duke vazhduar me problematikën e përditshme të funksionimit të të gjithë hallkave e strukturave të tij, ecurinë dhe dinamikën akademike, kërkimore – shkencore dhe administrative e financiare gjatë viteve të ekzistencës së tij. Në këto raporte janë pasqyruar me vërtetësi anët pozitive të funksionimit dhe ecurisë së veprimtarisë së UET-it, si dhe dobësitë e sfidat kryesore për të

ardhmen, duke e bërë atë një dokument real e mjaft të vlefshëm për të gjykuar e vlerësuar stadin aktual të gjendjes së tij, cilësinë dhe dinamikën e ndryshimeve gjatë periudhave respektive të ekzistencës së tij, si dhe mbi të gjitha, evidentimin e dobësive, duke propozuar edhe masat përkatëse për rregullimin e shpejtë e përfundimtar të tyre.

Një nga vlerat e Raporteve të Vlerësimit të Brendshëm në UET i përket procesit të hartimit, i cili ka qenë një proces përfshirës që është realizuar me pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë të UET-it. Nëse do të krahasonim pikat e dobëta të paraqitura në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të vitit 2009 me ato të pasqyruara në Raportin e vitit 2010, vihet qartazi në dukje një ndryshim cilësor, jo vetëm në kuptimin e ndryshueshmërisë mes tyre (në raportin e dytë të vlerësimit të brendshëm nuk gjenden pika të dobëta të identifikuar në raportin e parë), por edhe në rritjen cilësore të kërkesave të UET ndaj vetes për identifikimin e pikave të dobëta, në raport me standardet që UET ka vendosur në kuptimin afatgjatë, por edhe me kërkesat e tregut të punës dhe të tendencave të zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri e më gjerë.

Për ta konkretizuar atë ç'ka u tha më lart po sjellim një shembull. Një nga pikat e dobëta të identifikuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të vitit 2009 ka qenë, me të drejtë, fakti që raporti mes stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm ka qenë në favor të këtij të fundit, ndonëse raporti ekzistues ishte brenda standardeve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në dokument theksohet se ky fakt nuk përputhet me vullnetin, filozofinë dhe synimet afatgjata të UET-it dhe shtrohet si detyrë për t'u zgjidhur në të ardhmen e afërt. Në Raportin e vitit 2010, ky raport ka ndryshuar në mënyrë të thellë në dobi të numrit të stafit akademik të brendshëm. Po ama në Raportin e dytë është konstatuar si një pikë e dobët fakti se në UET në vitin 2010 ende nuk ishte gjetur pika e duhur e takimit të kërkimit shkencor me mësimdhënien. U konstatua se kërkimet shkencore të anëtarëve të stafit akademik të UET, pavarësisht se janë të lavdërueshme si për nga sasia edhe për nga cilësia nuk shihen gjithmonë me syrin e vënies së këtyre kërkimeve në funksion të mësimdhënies. Tashmë edhe kjo pikë dikur e dobët, jo vetëm që është adresuar, por edhe mund të konsiderohet e zgjidhur. Kjo është kthyer në një kërkesë akademike nëpërmjet pasqyrimin në dokumentet zyrtare administrative – rregullatore të UET, zbatimin e të cilave monitorohet në mënyrë periodike nga KSBC (përveç monitorimit dhe kontrollit nga autoritetet drejtuese dhe organet në UET). P.sh. në dokumentin përkatës i cili flet për hartimin e programit të lëndës, tek rubrika Literatura kërkohet që në literaturën e rekomanduar të pasqyrohen:

- 1- 1-2 tekste që janë më afër tematikës së kursit;
- 2- 5-10 libra bibliografi në shqip ose në gjuhë të huaj;
- 3- Botimet e pedagogut të lëndës në atë fushë;**
- 4- Botimet e UET Press-it që lidhen me lëndën;**

Kjo kërkesë nuk ka qenë në rregullat dhe procedurat e mëparshme të UET-it. Po ashtu në rubrikën “Libri i Leximeve” kërkohet një përmbledhje e literaturës më të domosdoshme, të rekomanduar në mbështetje të lëndës, si: artikuj, fashikuj, pjesë librash e revistash, artikujt përkatës të pedagogut të lëndës, artikuj të revistave shkencore të UET-it etj (Broshura e dokumenteve në zbatim të Statutit dhe Rregulloreve bazë të UET. 2011).

Jo vetëm kaq, por këtë vit akademik (2011 – 2012) në UET, çdo pedagog i brendshëm me

tituj e grada duhet të plotësojë një dokument të veçantë të quajtur Lecturer's papers, i cili përmban punimet e publikuara të çdo pedagogu me grada e tituj, e në të cilën përfshihen rubrikat:

1. Artikuj të botuar në revistat shkencore në Shqipëri (titulli i artikullit, autori/ët, revista, nr, viti i botimit, faqet në revistë, etj.).
2. Artikuj të botuar në revistat shkencore jashtë vendit. Kur artikulli nuk gjenden në rrugë elektronike dhe është i lidhur me lëndën(t) që trajtohet(n) në procesin mësimor apo me kërkimin shkencor në UET, ai duhet skanuar i plotë në Pdf dhe t'i bashkëngjitet materialeve që kërkohen në revistat shkencore.
3. Libra të botuar brenda dhe jashtë vendit (titulli, autori/ët, viti i botimit, shtëpia botuese, etj.). Në këtë rast, kur libri(at) është(janë) i(të) lidhur me procesin mësimor apo kërkimin shkencor në UET, duhet të skanohet faqja e parë ku gjenden titulli, autori, viti i botimit, shtëpia botuese; po ashtu abstrakti/hyrja ose përmbledhja si edhe pasqyra e lëndës, në mënyrë që të paraqiten në Pdf, duke ju bashkëngjitur materialeve që kërkohen.
4. Studime/raporte/referime në konferenca shkencore si edhe materiale të tjera studimore të autorit të publikuara, duke paraqitur titullin, autori/ët, vitin e publikimit, institucionin për të cilin është përgatitur punimi, dhe çdo informacion tjetër që autori e mendon se vlen. Për ato studime/raporte/referime, etj., për të cilat autori ka të drejtën e shpërndarjes në publik, e kur ato lidhen me lëndët dhe me akset e punës kërkimore dhe akademike që zhvillohet në UET, që nuk gjenden në mënyrë elektronike, ato duhen të skanojnë faqen e parë për t'u paraqitur në formën Pdf, ku gjenden titulli, autori, viti i publikimit, institucioni për të cilin është përgatitur; abstrakti/hyrja, ose përmbledhja dhe pasqyra e lëndës.

Përveç hartimit të Raporteve të plota të Vlerësimit të Brendshëm të performancës në UET, KSBC bën kontrollë tematike periodike dhe të planifikuara në përputhje me planin kalendar akademik të UET-it. (Dosja e mbledhjeve të Rektoratit të UET,2010-2011 dhe 2011-2012). Të tilla bëhen gjatë çdo semestri për problematika të tilla si:

1. Mbi korrektesën në hartimin e Programeve të çdo lënde.
2. Mbi zbatimin e standardeve në përgatitjen e Librit të Leximeve
3. Mbi respektimin e standardeve në hartimin e tezave të Provimeve në UET (të Ndërmjetëm, ose/dhe Përfundimtar), korrigjimin dhe mbarëvajtjen e seancave të sqarimit e tyre.
4. Mbi korrektesën e pedagogëve për hartimin, prezantimin e tyre tek studentët dhe korrigjimin e Detyrave të kursit.
5. Rreth Diplomave, korrektesa e dosjes së çdo studenti në prag të mbrojtjes, ngritjen e komisioneve përkatëse, ecurinë e procesit të mbrojtjes dhe dokumentacionin përmbyllës të tyre.
6. Mbi hartimin dhe realizimin e planit të punës kërkimore – shkencore (individual, ose si departament/fakultet) në UET.
7. Ecuria e Këshillimit akademik/tutoriati, korrektesa e dokumentacionit dhe e impaktit të tyre.
8. Korrektesa në zbatimin e orareve për Seancat metodologjike për udhëheqjet e diplomave në UET, dokumentimi i tyre, regjistrat, produktet e studentëve diplomantë etj.
9. Ecuria e grafikut të Leksioneve të hapura, cilësia dhe dokumentimi i tyre etj.

Mund të përmendja edhe dhjetëra aspekte të tjerë të veprimtarisë së KSBC në zbatim të misionit të vet për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UET, por për efekt të limiteve të vendosura mendoj se me këto shembuj krijohet një tablo e qartë dhe e argumentuar e asaj që u pretendua në krye të këtij referimi, që në UET i kushtohet një rëndësi e posaçme vlerësimit të brendshëm dhe sigurimit të cilësisë në UET

## **2- Procesi i vlerësimit të brendshëm të universiteteve, nevojë kyç për sigurimin e cilësisë në Arsimin e Lartë – Modeli i Universitetit European të Tiranës (UET)**

Çështja e cilësisë dhe e forcimit të saj është një problem tashmë i shtruar për shumë sektorë të jetës, si në ekonomi, biznes, bujqësi, administratë, marketing, sistemin e shërbimeve etj. Në literaturën përkatëse të ekspertëve që hulumtojnë mbi çështjet që lidhen me cilësinë (pavarësisht nga fushat) ka një debat ende të gjallë mbi konceptin dhe definicionin e cilësisë. Veçanërisht në arsimin e lartë, shumë stakeholders e kanë të vështirë të përcaktojnë saktë definicionin mbi cilësinë. Në fakt duhet pranuar se ky është një koncept relativ që ka domethënie të ndryshme për njerëz të ndryshëm. Për shembull, ndërsa flasin për cilësi në një institucion të arsimit të lartë, studentët mund të fokusohen në fasilitetet e ofruara dhe në dobinë e arsimimit për punësim në të ardhmen. Nga ana tjetër stafi akademik mund t'i japë rëndësi procesit të mësim-dhënies. Menaxhimi mund të jetë më i fokusuar tek arritjet administrative dhe menaxheriale të institucionit. Prindërit mund të konsiderojnë arritjet e fëmijëve të tyre. Ndërsa punëdhënësit mund të marrin në konsideratë kompetencën e të diplomuarve. Pra çdo grup interesi ka një qasje të ndryshme për të definuar konceptin cilësi. Ajo që mund të kuptohet nga këto shembuj është konkluzioni se është e pamundur të flitet për cilësinë si një koncept i vetëm.

Çdo përcaktim i cilësisë duhet të definohet në përputhje me kontekstin në të cilin ajo përdoret. Duke konsideruar këtë fakt Green ka listuar pesë qasje të ndryshme për cilësinë në fushën e arsimit të lartë. Sipas saj ky koncept mund të shihet:

- 1.Në kuptimin e përjashtimit (standardet më të larta)
- 2.Në kuptimin e përshtatshmërisë ndaj standardeve
- 3.Si përshtatje ndaj qëllimit
- 4.Si efektivitet në arritjen e qëllimeve institucionale
- 5.Si plotësim i nevojave të shpallura ose të nënkuptuara të klientit (Green. 1994)

Globalizimi ka ndikuar në arsimin e lartë dhe ka bërë që ai të ndeshet me një sërë sfidash. Dirk Van Damme, është i mendimit se ndoshta sfida më e rëndësishme për arsimin e lartë në shekullin XXI është zhvillimi i një qasjeje ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë dhe akreditimin. Sipas tij në këtë drejtim duhen ndërmarrë disa hapa, ndër të cilat i pari është rënia dakord për një set definicionesh dhe për një fjalor konceptesh në lidhje me sigurimin ndërkombëtar të cilësisë dhe akreditimit. (Van Damme, Dirk Gehnt University. 2001) Mbështetur në këtë rekomandim u shfaqën dy shtyllat kryesore konceptuale të procesit të sigurimit të cilësisë:

1. Sigurimi i brendshëm dhe
2. Sigurimi i jashtëm.

Sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë janë si dy anët e të njëjtës medalje. Në dokumentet zyrtare të Bolonjës të dy këto aspekte janë shfaqur që në takimin e Berlinit të vitit 2001. Standardet dhe Udhëzimet Europiane dhe Regjistri European që pasojnë procesin e Bolonjës, përbëjnë hapat kryesore zbatuese për sigurimin e cilësisë.

Këto dokumente pasqyrojnë kornizën për sistemet kombëtare të sigurimit të brendshëm në tre akse kryesore:

1. Sigurimi i brendshëm i cilësisë
2. Sigurimi i jashtëm i cilësisë dhe
3. Agjencitë e sigurimit të jashtëm të cilësisë

Nga pikëpamja e procesit të Bolonjës, sigurimi i brendshëm i cilësisë thekson se: “duke qenë në përputhje me autonominë institucionale, përgjegjësia parësore për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë i përket çdo institucioni në vetvete dhe kjo pasqyron bazën për llogaridhënie reale të sistemit akademik brenda kornizës kombëtare të cilësisë” (Dionyssis. 2008). Ky koncept u theksua edhe në Komunikatën e Bergenit të vitit 2005, në të cilën u kërkua që institucionet e arsimit të lartë të intensifikonin përpjekjet e tyre për cilësi të veprimtarive të tyre, duke ndërtuar mekanizma të brendshme, të cilat duhet të kenë korrelacion të drejtpërdrejtë me sigurimin e jashtëm të cilësisë (Dionyssis. 2008). Ky koncept u pasurua në Komunikatën e Londrës në vitin 2007 ku u theksua se meqenëse përgjegjësia kryesore për cilësinë u takon institucioneve të arsimit të lartë, ato duhet të zhvillojnë sistemet e tyre për sigurimin e cilësisë. Sfida më e madhe e institucioneve të arsimit të lartë u theksua krijimi i kulturës së cilësisë brenda komunitetit të tyre institucional. (Dionyssis. 2008)

Kultura e cilësisë i referohet një kulture organizative që synon të theksojë në vijimësi cilësinë dhe karakterizohet nga dy elementë të pastër: nga njëra anë një element kulturor/psikologjik të ndarjes së vlerave, besimeve, pritshmërive dhe përkushtimit ndaj cilësisë, dhe nga ana tjetër një element strukturor/menaxherial me procese të përcaktuara që thekson cilësinë dhe synon koordinimin e përpjekjeve individuale. (European University Association. 2006). Diskutimet e fundit mbi cilësinë dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë janë bërë kaq shumë unanime në drejtim të kërkesës për nxitjen e kulturës së cilësisë, sa që shpesh kultura e cilësisë konsiderohet si një sinonim për “zhvillimin e, dhe në pajtim me, proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë (Harvey. 2009.) Në përputhje me këto orientime tashmë janë ndërtuar dhe pranuar Standardet dhe Udhëzimet Europiane, specifiku për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Ato janë (Harvey. 2009):

1. Strategjia, politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm
2. Aprovimi, monitorimi dhe rishikimi periodik i programeve
3. Vlerësimi i studentëve
4. Sigurimi i cilësisë së stafit akademik
5. Burimet e të nxëniet dhe mbështetja ndaj studentit
6. Sistemet e informimit
7. Informimi i publikut

Në Shqipëri tashmë është ngritur Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL). APAAL-i është një institucion shtetëror dhe publik, pjesë e Sistemit të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë në Shqipëri, në varësi administrative të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, e krijuar me vendim të KM nr. 303, datë 1.7.1999 “Për krijimin e sistemit të akreditimit në arsimin e lartë”. APAAL ka si mision kryesor të saj sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Për realizimin e misionit të vet APAAL-i mbështetet në disa parime themelore si respektimin e autonomisë institucionale dhe lirisë akademike të Institucioneve të Arsimit të Lartë, transparencën dhe informimin në çdo hap të procesit, mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë në IAL, objektivizmin dhe profesionalizmin në të gjitha proceset e kryera prej saj si dhe në respektimin vetëm të kriterëve dhe standardeve shtetërore të cilësisë, të standardeve evropiane të cilësisë dhe në standartet akademike në AL. APAAL-i është përgjegjës për vlerësimin e jashtëm si të universiteteve publike, ashtu të atyre private (APAAL. 2011).

Universiteti Europian i Tiranës (UET) ka realizuar me sukses disa vlerësime të brendshme dhe të jashtme, dhe aktualisht gëzon statusin e universitetit dhe është i akredituar si institucion dhe ka të akredituara të gjitha programet e studimit për të cilat ka lëshuar diploma. Në UET i kushtohet një rëndësi e dorës së parë sigurimit të brendshëm të cilësisë. Sigurimi i brendshëm i cilësisë në UET shihet si një proces që shtrihet në dy plane:

1. Së pari në zbatimin me korrektesë të përgjegjësive sipas hierarkisë vendim-marrëse brenda universitetit, dhe
2. Së dyti si funksion i një entiteti të veçantë, të ngritur posaçërisht për këtë qëllim, të quajtur Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC)

Në rastin e UET nuk do të ndalem tek aspekti i parë, por në të dytin, duke u fokusuar tek sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë në UET dhe në misionin, funksionet, përbërjen dhe veprimtarinë e KSBC. Në trajtimin e këtij komponenti do të mbështetem tek dokumentacioni themelor i UET, i cili përfshin Statutin e UET, Rregullores bazë të këtij institucioni, tek Broshura e dokumenteve në zbatim të Statutit dhe Rregulloreve bazë të UET, në formatet dhe formularët e miratuar si dhe në veprimtarinë konkrete të KSBC. Neni 11 i Statutit të UET bën fjalë për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. (Statuti i Universitetit Privat UET. 2011) Në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë në pikën 11.1 shpallet: “Sigurimi i brendshëm i cilësisë është vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të UET-it. Ky vlerësim kryhet të paktën 1 (një) herë në 5 (pesë) vite, por gjithashtu mund të kryhet sa herë shihet e arsyeshme, si vlerësim i përgjithshëm ose i pjesshëm. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet nga vetë institucioni nëpërmjet:

1. Strukturave hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të UET-it, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij.
2. Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila vlerëson efikasitetin e veprimtarive akademike, administrative dhe financiare të universitetit dhe harton Raportin përkatës të Vlerësimit të Brendshëm – RVB. Ky raport diskutohet në të gjitha njësitë e UET-it, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen.

Në Rregulloren bazë të UET neni 7 i kushtohet specifikisht njësisë përgjegjëse për cilësinë Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ky nen thekson se KSBC është njësi autonome operative e përhershme në strukturën organizative të Universitetit. Komisioni vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore, si dhe të veprimtarisë administrative e financiare të UET-it. Për ushtrimin e funksioneve të tij, KSBC-ja ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Komisioni përbëhet nga Kryetari si edhe nga anëtarë që përfaqësojnë çdo fakultet, personelin ndihmës – akademik ose administrativ, si dhe një anëtar përfaqësues nga Këshilli i Studentëve (Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës. 2011).

Në Broshurën e dokumenteve në zbatim të Statutit dhe Rregulloreve të UET (Broshura e Dokumenteve në zbatim të rregulloreve, UET), një pikë e veçantë i kushtohet dy aspekteve të rëndësishme:

1. Sigurimit të brendshëm të cilësisë (SBC) dhe
2. Strukturave përgjegjëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë

Për SBC në këto dokumente përcaktohen parimet mbi të cilat ndërtohet SBC, qëllimet e SBC dhe objektivat e SBC. Parimet mbi të cilat ndërtohet Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë – SBC-së në UET janë:

1. Krijimi i një tabloje të qartë dhe reale rreth gjendjes aktuale të UET në momentin e dhënë;
2. Ngritja e sistemit të brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe krijimi i kulturës së cilësisë në institucion.
3. Garantimi i transparencës me qëllim informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerë për performancën e UET-it, njësisë të tij, programeve, kurrikulave, shërbimeve etj  
Qëllimet e SBC-së janë:

1. Rritja e vazhdueshme e cilësisë së drejtimit të UET-it, nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave bashkëkohore, si edhe angazhimit të të gjitha niveleve drejtuese dhe organizative.

2. Aplikimi i vazhdueshëm i filozofisë së UET-it, duke zbatuar një program akademik që përkon si nga ana konceptuale dhe kronologjikisht me synimet që ka UET-i.

Rritja e vazhdueshme e cilësisë së formimit të studentëve, duke u ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat më bashkëkohore të mësimdhënies dhe duke nxitur të qenin proaktiv e kritik në dhënieve e opinioneve mbi çështje aktuale. Objektivat e SBC-së janë:

1. Monitorimi i vazhdueshëm i drejtimit të institucionit.
2. Ndjekja e vazhdueshme e gjendjes së programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre, nëpërmjet krijimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së mekanizmave zyrtare për miratimin, vlerësimin periodik dhe për monitorimin e programeve dhe diplomave.
3. Ndjekja e vazhdueshme e nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës, si edhe kualifikimit të tij.
4. Monitorimi i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe i vlerësimit të studentëve dhe ruajtja e cilësisë së tij.
5. Ndjekja e vazhdueshme e ecurisë së kërkimit shkencor në institucion.
6. Monitorimi i nivelit të përfshirjes së studentëve në veprimtaritë e përditshme të



institucionit.

7.Ndjekja e ecurisë së bashkëpunimit të UET-it me institucione të tjera akademike dhe joakademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

8.Shtirirja e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në të gjitha hallkat organizative të institucionit.

Në lidhje me strukturat përgjegjëse për SBC në dokumentet bazë përcaktohen dy kategori strukturash:

- 1.Strukturat hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të UET-it;
- 2.Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – KSBC, nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive që ushtrohen në UET, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Për KSBC, në këto dokumente, përcaktohet përbërja e tij, kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të tij, funksioni i tij, si dhe marrëdhëniet e tij (dhe të UET-it) me APAAL-in. KSBC-ja përbëhet nga Kryetari i Komisionit, një përfaqësues nga pedagogët e çdo Fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik, ose administrativ, një përfaqësues nga organizatat studentore si dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm. Në përzgjedhjen e anëtarëve merren parasysh kriteret e mëposhtme:

- 1.Kompetencat profesionale;
- 2.Paanshmëria;
- 3.Mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin
- 4.Shkalla e nevojshme e njohjes të anëtarëve të Komisionit;
- 5.Të mos jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET-it.

KSBC vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore ose artistike, si dhe efikasitetin e veprimtarive administrative dhe financiare të institucionit. Ai përgatit Dosjen e Vetëvlerësimit, pjesë e së cilës është edhe Raporti i Vetëvlerësimit. KSBC-ja ka autonomi operative dhe akses në të dhënat e institucionit. Rezultatet e KSBC-së publikohen. Kryetari i KSBC-së merr pjesë rregullisht në mbledhjet e Rektoratit. KSBC-ja ndërton marrëdhënie bashkëpunimi me APAAL-in dhe, në bashkërendim me të harton një plan kontaktesh e vizitash në institucion. KSBC-ja krijon dhe mban në vijimësi marrëdhënie me institucione pjesëmarrëse në Rrjetin Europian të Sigurimit të Cilësisë, të cilat pas vendimit të Rektoratit, mund të ftohen të zhvillojnë kontrollin e jashtëm të UET-it.

Për të garantuar zbatimin e kriterëve, procedurave dhe standardeve të vendosura, në UET janë hartuar një numër i konsiderueshëm formatesh e formularësh (mbi 50 të tillë), të cilët mbulojnë të gjitha veprimtaritë akademike, ndihmëse – mësimore dhe administrative të këtij institucioni dhe shtrihen në të tre ciklet e studimit. Ato përfshijnë ndërtimin e programit të lëndës dhe indikatorët e vlerësimit të tij, hartimin e tezave të provimeve, detyrat e kursit, tutoriati, praktika profesionale, diplomat, fushat e ekspertizës së stafit akademik në funksion të udhëheqjeve të diplomave, plani individual dhe i integruar i punës kërkimore – shkencore të pedagogut, check-list për organizimin e veprimtarive kërkimore – shkencore, vlerësimi i veprimtarisë kërkimore – shkencore, përkthimet dhe redaktimet e botimeve të UET – PRESS, kërkesat dhe ankesat e studentëve, pasurimi i literaturës së lëndës, kërkesa për



leje, angazhimi i pedagogëve të huaj, vlerësimi i performancës së pedagogut (vetëvlerësim, vlerësim nga kolegu/eprori, vlerësim nga studentët), ngarkesa e pedagogut, realizimi i normës së çdo pedagogu etj. Siç u theksua edhe më lart, sigurimi i zbatimit të të gjithë këtij sistemi është detyrë përveç se e strukturave hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të UET-it, edhe e Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – KSBC. KSBC në UET e ushtron këtë përgjegjësi nëpërmjet dy formave të kontrollit:

1. Vlerësimin të plotë të performancës së universitetit dhe
  2. Vlerësimin tematik të aspekteve të caktuara të veprimtarisë së Universitetit.
- Në UET Vlerësimi i plotë i brendshëm i performancës së universitetit është realizuar, ashtu sikurse e kërkon edhe kuadri ligjor, sa herë ka qenë e nevojshme për akreditimin, si institucion dhe të të gjitha programeve të studimit. Në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues, si dhe në zbatim të udhëzimeve të APAAL-it aspektet kryesore për vlerësimin e plotë të brendshëm të performancës së universitetit kanë qenë:
3. Misioni dhe Objektivat e Institucionit të Arsimit të Lartë (IAL), të një programi, të një kurrikule etj.
  4. Struktura organizative e IAL, e njësisë përbërëse dhe menaxhimi i tij
  5. Analiza e kurseve të studimit, diplomave Master etj.
  6. Programet e studimit, organizimi i kurrikulave, marrëveshja e Bolonjës, kreditet
  7. Stafit mësimdhënës dhe mbështetës
  8. Mësimdhënia
  9. Kërkimi shkencor
  10. Studentët dhe pasuniversitarët
  11. Fasilitetet, burimet materiale, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit
  12. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare
  13. Sistemi i brendshëm i Sigurimit të Cilësisë
  14. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Secili nga këto aspekte shoqërohet qartazi me nën aspektet përkatëse. Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm është ndërtuar në përputhje të plotë me Treguesit e matshëm për vlerësimin e cilësisë në arsimin e lartë. (APAAL.Udhëzues për vlerësimin e brendshëm të cilësisë në arsimin e lartë. 2005) KSBC deri tani ka realizuar 2 Raporte të plota të Vlerësimit të Brendshëm, njërin në vitin 2009 për akreditimin e UET institucionalisht dhe programet e nivelin Bachelor dhe një në vitin 2010 për akreditimin e programeve Master. KSBC ka përgatitur edhe Raportin e tretë të Vlerësimit të Brendshëm për akreditimin e programeve të reja qoftë në Bachelor, qoftë në Master. Për përgatitjen e Raporteve të Vlerësimit të Brendshëm procesi ka kaluar në disa etapa:

Së pari është organizuar një takim i veçantë mes KSBC-së dhe specialistëve të APAAL-it, takim i cili ka shërbyer për t'u njohur më specifikisht me afatet dhe detyrimet e procesit të vlerësimit. Për përgatitjen e Raportit të parë të Vlerësimit të brendshëm në UET (2009), është ngritur paraprakisht Grupi i Vetëvlerësimit. Funkcionimi i tij është kryer në përputhje me Udhëzimin e miratuar nga Senati Akademik i UET-it, më datë 02.03.2009: “Për organizimin dhe funksionimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe organizimit të sistemit të vlerësimit të brendshëm” (Raporti i vlerësimit të brendshëm. 2009). Në zbatim të këtij Udhëzimi, Grupi i Vetëvlerësimit u ngrit nën përgjegjësinë e Rektorit, pasi ky i fundit mori edhe mendimin e Senatit. Brenda grupit u përcaktuan detyrat dhe përgjegjësitë për çdo

anëtari. Në Grupin e Vetëvlerësimit u përfshi edhe Kryetari i Këshillit Studentor. Ashtu sikurse ishte paraparë dhe shprehur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të vitit 2009, Grupi i vetëvlerësimit u kthye më pas në një grup vlerësimi permanent dhe të institucionalizuar (sot KSBC). Në terma afatgjatë, përvoja e vlerësimit të brendshëm të vitit 2009 ka shërbyer si hap i rëndësishëm për të konsoliduar dhe forcuar Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në UET dhe instalimin e kulturës së cilësisë. Më pas Grupi i Vetëvlerësimit, (i quajtur më vonë KSBC), përgatiti Dosjen e Vetëvlerësimit, pjesë e së cilës ishte dhe Raporti i Vetëvlerësimit.

Grupi i Vetëvlerësimit u trajnua nga stafi i APAAL-it dhe ju vunë në dispozicion materialet udhëzuese për vlerësimin, organizimin e grupit dhe të punës. Po ashtu u realizua edhe njohja me procesin, detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e secilit anëtar. Të gjitha Vetëvlerësimet janë kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në zbatim të udhëzimeve të dhëna nga APAAL-i. Grupi i Vetëvlerësimit ka qëndruar në kontakt të vazhdueshëm me përfaqësues dhe specialistë të APAAL-it. Produkt i këtij procesi të vetëvlerësimit është Dosja e Vetëvlerësimit, në përbërje të së cilës, vend qendror zë Raporti i Vetëvlerësimit, i cili në fazën e draftimit u konsultua me të gjithë stafin e UET-it. Në përbërje të Dosjes së Vetëvlerësimit janë përfshirë (Raport i Vetëvlerësimit”, UET 2009 dhe 2010):

1. Mendimi me shkrim i Rektorit;
2. Raporti i Vetëvlerësimit, i ndarë në dy pjesë:
  - 2.1 Pjesa e Parë: Pjesa analitike dhe përshkruese e Raportit
  - 2.2 Pjesa e Dytë: Informacionet sasiore, sipas indikatorëve.
- 3-Dokumentacioni i kërkuar në mbështetje të vlerësimit

Gjatë gjithë procesit të përgatitjes së Raportit, Grupi i Vetëvlerësimit/KSBC ka pasur parasysh të përfshijë mendimet më të vjera të stafit akademik dhe atij ndihmës, si dhe të studentëve, çka ka shërbyer edhe si një fushatë informimi në lidhje me procesin e vlerësimit të brendshëm dhe pasqyrimin e tij në Raportin përkatës. Për mbledhjen e mendimeve të stafit dhe të studentëve janë organizuar takime formale dhe informale, ndërsa njohja përfundimtare me Raportin e Vetëvlerësimit është bërë në një takim të të gjithë njësisë, ku janë diskutuar të dhënat, mendimet, komentet dhe rekomandimet e shprehura në raport. Edhe në këtë fazë, Grupi i Vetëvlerësimit/KSBC ka qenë i hapur ndaj mendimeve të ndryshme dhe ka përfshirë në versionin përfundimtar të Raportit mendimet, sugjerimet apo komentet e argumentuara. Raportet i Vetëvlerësimit shprehin në mënyrë të detajuar e reale situatën, ecurinë dhe problematikën e funksionimit të UET-it, me fokus programet e studimit përkatëse në situatën e dhënë. Aty analizohen dhe jepen me detaje të gjitha aspektet akademike, ligjore e organizative, duke filluar nga strategjia e objektivat e UET-it, duke vazhduar me problematikën e përditshme të funksionimit të të gjithë hallkave e strukturave të tij, ecurinë dhe dinamikën akademike, kërkimore – shkencore dhe administrative e financiare gjatë viteve të ekzistencës së tij. Në këto raporte janë pasqyruar me vërtetësi anët pozitive të funksionimit dhe ecurisë së veprimtarisë së UET-it, si dhe dobësitë e sfidat kryesore për të ardhmen, duke e bërë atë një dokument real e mjaft të vlefshëm për të gjykuar e vlerësuar stadin aktual të gjendjes së tij, cilësinë dhe dinamikën e ndryshimeve gjatë periudhave respektive të ekzistencës së tij, si dhe mbi të gjitha, evidentimin e dobësive, duke propozuar edhe masat përkatëse për rregullimin e shpejtë e përfundimtar të tyre. Një nga vlerat e Raporteve të Vlerësimit të Brendshëm në UET i përket procesit të hartimit, i cili ka qenë një

proces përfshirës që është realizuar me pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë të UET-it. Nëse do të krahasonim pikat e dobëta të paraqitura në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të vitit 2009 me ato të pasqyruara në Raportin e vitit 2010, vihet qartazi në dukje një ndryshim cilësor, jo vetëm në kuptimin e ndryshueshmërisë mes tyre (në raportin e dytë të vlerësimit të brendshëm nuk gjenden pika të dobëta të identifikuar në raportin e parë), por edhe në rritjen cilësore të kërkesave të UET ndaj vetes për identifikimin e pikave të dobëta, në raport me standardet që UET ka vendosur në kuptimin afatgjatë, por edhe me kërkesat e tregut të punës dhe të tendencave të zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri e më gjerë.

Për ta konkretizuar atë ç'ka u tha më lart po sjellim një shembull. Një nga pikat e dobëta të identifikuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të vitit 2009 ka qenë, me të drejtë, fakti që raporti mes stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm ka qenë në favor të këtij të fundit, ndonëse raporti ekzistues ishte brenda standardeve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në dokument theksohet se ky fakt nuk përputhet me vullnetin, filozofinë dhe synimet afatgjata të UET-it dhe shtrohet si detyrë për t'u zgjidhur në të ardhmen e afërt. Në Raportin e vitit 2010, ky raport ka ndryshuar në mënyrë të thellë në dobi të numrit të stafit akademik të brendshëm. Po ama në Raportin e dytë është konstatuar si një pikë e dobët fakti se në UET në vitin 2010 ende nuk ishte gjetur pika e duhur e takimit të kërkimit shkencor me mësimdhënien. U konstatua se kërkimet shkencore të anëtarëve të stafit akademik të UET, pavarësisht se janë të lavdërueshme si për nga sasia edhe për nga cilësia nuk shihen gjithmonë me syrin e vënies së këtyre kërkimeve në funksion të mësimdhënies.

Tashmë edhe kjo pikë dikur e dobët, jo vetëm që është adresuar, por edhe mund të konsiderohet e zgjidhur. Kjo është kthyer në një kërkesë akademike nëpërmjet pasqyrimin në dokumentet zyrtare administrative – rregullatore të UET, zbatimi i të cilave monitorohet në mënyrë periodike nga KSBC (përveç monitorimit dhe kontrollit nga autoritetet drejtuese dhe organet në UET).

P.sh. në dokumentin përkatës i cili flet për hartimin e programit të lëndës, tek rubrika Literatura kërkohet që në literaturën e rekomanduar të pasqyrohen:

1.1-2 tekste që janë më afër tematikës së kursit;

2. 5-10 libra bibliografi në shqip ose në gjuhë të huaj;

3. Botimet e pedagogut të lëndës në atë fushë;

4. Botimet e UET Press-it që lidhen me lëndën;

Kjo kërkesë nuk ka qenë në rregullat dhe procedurat e mëparshme të UET-it. Po ashtu në rubrikën “Libri i Leximeve” kërkohet një përmbledhje e literaturës më të domosdoshme, të rekomanduar në mbështetje të lëndës, si: artikuj, fashikuj, pjesë librash e revistash, artikujt përkatës të pedagogut të lëndës, artikuj të revistave shkencore të UET-it etj. (Broshura e dokumenteve në zbatim të Statutit dhe Rregulloreve bazë të UET. 2011).

Jo vetëm kaq, por këtë vit akademik (2011 – 2012) në UET, çdo pedagog i brendshëm me tituj e grada duhet të plotësojë një dokument të veçantë të quajtur Lecturer's papers, i cili përmban punimet e publikuara të çdo pedagogu me grada e tituj, e në të cilën përfshihen rubrikat:

5. Artikuj të botuar në revistat shkencore në Shqipëri (titulli i artikullit, autori/ët, revista, nr, viti i botimit, faqet në revistë, etj.).

6. Artikuj të botuar në revistat shkencore jashtë vendit. Kur artikulli nuk gjenden në rrugë

elektronike dhe është i lidhur me lëndën(t) që trajtohet(n) në procesin mësimor apo me kërkimin shkencor në UET, ai duhet skanuar i plotë në Pdf dhe t'i bashkëngjitet materialeve që kërkohen në revistat shkencore.

7.Libra të botuar brenda dhe jashtë vendit (titulli, autori/ët, viti i botimit, shtëpia botuese, etj.). Në këtë rast, kur libri(at) është(janë) i(të) lidhur me procesin mësimor apo kërkimin shkencor në UET, duhet të skanohet faqja e parë ku gjenden titulli, autori, viti i botimit, shtëpia botuese; po ashtu abstrakti/hyrja ose përmbledhja si edhe pasqyra e lëndës, në mënyrë që të paraqiten në Pdf, duke ju bashkëngjitur materialeve që kërkohen.

8.Studime/raporte/referime në konferenca shkencore si edhe materiale të tjera studimore të autorit të publikuara, duke paraqitur titullin, autori/ët, vitin e publikimit, institucionin për të cilin është përgatitur punimi, dhe çdo informacion tjetër që autori e mendon se vlen. Për ato studime/raporte/referime, etj., për të cilat autori ka të drejtën e shpërndarjes në publik, e kur ato lidhen me lëndët dhe me akset e punës kërkimore dhe akademike që zhvillohet në UET, që nuk gjenden në mënyrë elektronike, ato duhen të skanojnë faqen e parë për t'u paraqitur në formën Pdf, ku gjenden titulli, autori, viti i publikimit, institucioni për të cilin është përgatitur; abstrakti/hyrja, ose përmbledhja dhe pasqyra e lëndës.

Përveç hartimit të Raporteve të plota të Vlerësimit të Brendshëm të performancës në UET, KSBC bën kontrollë tematike periodike dhe të planifikuara në përputhje me planin kalendar akademik të UET-it. (Dosja e mbledhjeve të Rektoratit të UET,2010-2011 dhe 2011-2012). Të tilla bëhen gjatë çdo semestri për problematika të tilla si:

- 1.Mbi korrektesën në hartimin e Programeve të çdo lënde.
- 2.Mbi zbatimin e standardeve në përgatitjen e Librit të Leximeve
- 3.Mbi respektimin e standardeve në hartimin e tezave të Provimeve në UET (të Ndërmjetëm, ose/dhe Përfundimtar), korrigjimin dhe mbarëvajtjen e seancave të sqarimit e tyre.
- 4.Mbi korrektesën e pedagogëve për hartimin, prezantimin e tyre tek studentët dhe korrigjimin e Detyrave të kursit.
- 5.Rreth Diplomave, korrektesa e dosjes së çdo studenti në prag të mbrojtjes, ngritjen e komisioneve përkatëse, ecurinë e procesit të mbrojtjes dhe dokumentacionin përmbyllës të tyre.
- 6.Mbi hartimin dhe realizimin e planit të punës kërkimore – shkencore (individual, ose si departament/fakultet) në UET.
- 7.Ecuria e Këshillimit akademik/tutoriati, korrektesa e dokumentacionit dhe e impaktit të tyre.
- 8.Korrektesa në zbatimin e orareve për Seancat metodologjike për udhëheqjet e diplomave në UET, dokumentimi i tyre, regjistrat, produktet e studentëve diplomantë etj.
- 9.Ecuria e grafikut të Leksioneve të hapura, cilësia dhe dokumentimi i tyre etj.

Mund të përmendja edhe dhjetëra aspekte të tjerë të veprimtarisë së KSBC në zbatim të misionit të vet për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UET, por për efekt të limiteve të vendosura mendoj se me këto shembuj krijohet një tablo e qartë dhe e argumentuar e asaj që u pretendua në krye të këtij referimi, që në UET i kushtohet një rëndësi e posaçme vlerësimit të brendshëm dhe sigurimit të cilësisë në UET. Në përfundim të këtij parashtrimi mund të konkludoj se vlerësimi i brendshëm i cilësisë në UET përbën një nga pikat e forta të këtij universiteti. Në këtë universitet tashmë është ngritur dhe funksionon rregullisht sistemi

i sigurimit të brendshëm të cilësisë, zbatimi i të cilit garantohej jo vetëm nga strukturat hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të UET-it, por veçanërisht nga njësia për kontrollin e brendshëm të cilësisë KSBC. Kam mendimin se i gjithë ky sistem dhe kjo përvojë mund të shërbejnë si një model i avancuar që siguron në fund të fundit cilësinë e programeve të studimit, shërbimeve dhe të diplomave në Universitetin Europian të Tiranës. Sidoqoftë standardet e cilësisë në arsimin e lartë, duke u kushtëzuar nga kërkesat e tregut të punës, nga kërkesat e klientëve dhe përfituesve të këtij shërbimi si dhe nga tendencat për t'u përballur me institucionet e tjera të arsimit të lartë në Shqipëri, rajon, Evropë e më gjerë, vijnë duke u rritur. Kësaj tendence i duhet përgjigjur me garanci më profesionale dhe tregues më të besueshëm. Kjo përbën sfidën kryesore të UET-it dhe të gjithë arsimit të lartë në Shqipëri.

### **3-Konkluzion:**

Në përfundim të këtij parashtrimi mund të konkludoj se vlerësimi i brendshëm i cilësisë në UET përbën një nga pikat e forta të këtij universiteti. Në këtë universitet tashmë është ngritur dhe funksionon rregullisht sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë, zbatimi i të cilit garantohej jo vetëm nga strukturat hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të UET-it, por veçanërisht nga njësia për kontrollin e brendshëm të cilësisë KSBC.

Kam mendimin se i gjithë ky sistem dhe kjo përvojë mund të shërbejnë si një model i avancuar që siguron në fund të fundit cilësinë e programeve të studimit, shërbimeve dhe të diplomave në Universitetin Europian të Tiranës.

Sidoqoftë standardet e cilësisë në arsimin e lartë, duke u kushtëzuar nga kërkesat e tregut të punës, nga kërkesat e klientëve dhe përfituesve të këtij shërbimi si dhe nga tendencat për t'u përballur me institucionet e tjera të arsimit të lartë në Shqipëri, rajon, Evropë e më gjerë, vijnë duke u rritur. Kësaj tendence i duhet përgjigjur me garanci më profesionale dhe tregues më të besueshëm. Kjo përbën sfidën kryesore të UET-it dhe të gjithë arsimit të lartë në Shqipëri.

## Referencat:

Green, D. (1994) What is quality in higher education? Buckingham: SRHE; Open University Press

Van Damme, Dirk, Prof. Dr. Ghent University / Flemish Interuniversity Council, HIGHER EDUCATION IN THE AGE OF GLOBALISATION: The need for a new regulatory framework for recognition, quality assurance and accreditation; Introductory Paper for the UNESCO Expert Meeting; Paris, (10-11 September 2001).

Dionyssis, Kladis: "European Standards and Guidelines for Internal Quality Assurance", punim i mbajtur në EU/CoE PROJECT "STRENGTHENING HIGHER EDUCATION REFORMS IN SERBIA", Conference on self-evaluation of higher education institutions, Belgrade, Serbia, (10-11 July 2008).

European University Association (EUA), 2006, Quality culture in European universities: a bottom-up approach. Report on the three rounds of the Quality Culture project (2002 – 2006) (Brussels, EUA), <http://www.eua.be/publications>

Harvey, L., (2009), Deconstructing quality culture, EAIR Conference in Vilnius 2009, <http://www.qualityresearchinternational.com/HarveyVilnius.pdf>.

Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area. ENQA report on Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area, Helsinki, Finland, (2009).

Woodhouse, D. (2006). —Quality = Fitness for Purpose (FFP): Definition for all seasons. Paper presented at the APQN Conference on Cooperation in Quality Assurance, Shanghai, (1-4 March 2006).

Hofmann, S. (2006). —Mapping external quality assurance in Central and Eastern Europe. A comparative survey by the Central and Eastern European Network of Quality Assurance in Higher Education. Occasional Paper 8. Helsinki: ENQA. Available at: [www.enqa.net/pubs.lasso](http://www.enqa.net/pubs.lasso)

El-Khawas, E. (2001). Accreditation in the United States: Origins, developments and future prospects. Paris: IIEP-UNESCO.

CICA, (2008). The UFE candidates' competency map: Understanding the professional competencies evaluated on the UFE. Ontario: CICA.

D'Andrea, V.M. and D. Gosling. (2005). Improving Teaching and Learning in Higher Education: A Whole Institution Approach. Buckingham: Society for Research into Higher Education and Open University Press.

Harvey, L. & Stensaker B., (2008), "Quality Culture: understandings, boundaries and linkages", in European Journal of Education, vol. 43, n°4.

Ligji Nr.9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjet Nr 9832, datë 12.11.2007, Nr 10307, datë 22.7.2010, Nr 10493, datë 15.12.2011 “Udhëzues për vlerësimin e brendshëm të cilësisë në arsimin e lartë”, APAAL, (2005);

“Aspektet dhe treguesit e vlerësimit të cilësisë në arsimin e lartë”, APAAL, (2005)  
Statuti i UET, (2010)

Rregullore bazë e UET, (2011)

Broshura e dokumenteve në zbatim të Statutit dhe rregulloreve bazë të UET, (2011)

Formate dhe formularë, UET, (2011-2012)

Raport i i Vetëvlerësimit, (2009)

Raport i i Vetëvlerësimit, (2010)

Dosjet e mbledhjeve të Rektoratit UET për vitin akademik (2010-2011 dhe 2011-2012).  
Raporte të KSBC, viti akademik (2010-2011 dhe 2011-2012).

## **The Commercialize of Higher Education and the Legal Framework in Privat Higer Education in Albania**

### **Abstract**

*In the last ten (10) years Albania has faced the phenomena of the extension of higher education. One legal complex framework approved provides and regulates the license and thereafter the accreditation of the private higher education institution. In Albania have now, 13 Public Higher Education Institutions and 46 Private Higher Education Institutions (HEI).*

*The phenomenon of commercialisation of higher education is not only in Albania. It is one typical and common phenomena of eastern ex-communist countries where the right to study in the university is a privilege for the “elite” class. This article will focus in three main directions:*

- 1.The situation of higher education in the Balkan countries and the role of private higher education sector*
- 2.The mechanism of quality control. The Public Agency for Accreditation of Higher Education*
- 3.The Albanian legal framework in private higher education*

*This article aims to indicate the important role that plays in the private higher education sector. It shows the promoting of competition between the public and private higher institutions. This competition has a positive impact for improving the higher education in Albania. Facing each other, both the public and private HEI have the same objective: to offer the quality standards and to be competitive in the market of higher education.*

**Keywords:** *Higher education, Commercialisation of Higher Education, Quality, Legal Framework of HEI*



## Abstrakt

*Në këtë 10 vjeçar të fundit, Shqipëria është ndodhur përballe fenomenit të masivizimit të arsimit të lartë. Komercializimi i arsimit si shërbim, sot ka sjellë që ai të ofrohet edhe nga Institucionet private. Në Shqipëri ka tashme 13 Institucione publike të arsimit të lartë dhe 46 private.*

*Një kuadër ligjor kompleks, rregullon krijimin, licensimin, dhe më pas akreditimin e institucioneve private të arsimit të lartë.*

*Fenomeni i komercializimit të arsimit të lartë, nuk është vetëm shqiptar. Ai është një fenomen tipik i vendeve ish komuniste, në të cilat e drejta për arsim i takonte vetëm një shtrese të quajtur “elitare”. Artikulli, do të fokusohet në tre drejtime kryesore:*

- 1. Situata në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe roli i sektorit privat të arsimit të lartë.*
- 2. Mekanizmat e kontrollit të cilësisë. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë.*
- 3. Kuadri ligjor shqiptar në fushën e arsimit të lartë privat.*

*Artikulli, synon të evidentojë rolin që luan sektori privat, në arsimin e lartë, i cili nxit konkurrencën midis Institucioneve publike dhe atyre private, si dhe midis vetë privatëve, dhe jep një impakt pozitiv në zhvillimin e arsimit të lartë në Shqipëri.*

*Duke u vendosur përballë njëri-tjetrit, IAL publike dhe ato private, kanë të njëjtin qëllim, të ofrojnë standarde dhe të jenë kompetitive në tregun e arsimit të lartë.*

**Fjalët Kyçe:** *Arsimi i Lartë, Komercializimi në Arsimit të Lartë, Cilësia, Kuadri Ligjor i IAL*

## **1-Hyrje: Komercializmi i Arsimit të Lartë dhe Korniza Ligjore e Arsimit të Lartë Privat në Shqipëri**

Shqipëria, Mali i Zi, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, dhe Serbia (të quajtuara “vende të Europës Juglindore”) gjithnjë e më tepër po karakterizohen nga një zhvillim i tyre politik dhe ekonomik. Në kuadër të Marrëveshjeve të Stabilizimit-Asocimit, lidhur midis tyre dhe vendeve anëtare të BE, ato po synojnë që të integrohen në BE, dhe arsimin e lartë ta reformojnë në funksion të proceseve integrale.

“Akhenda e Lisbonës”, me anë të së cilës vendet e Bashkimit Europian synojnë të bëhen rajoni më konkurrues i botës, ka ofruar kuadrin për zhvillimin ekonomik edhe të vendeve të Europës Juglindore, dhe në këtë aspekt edhe të arsimit të lartë. Vendosja e ekonomive tregut në këto vende, kërkon që ato të jetë konkurruese, si një kusht thelbësor për anëtarësimin në BE, ku midis të tjerave, edhe arsimit të lartë si një shërbim publik, sot ofrohet si nga sektori publik ashtu dhe nga ai privat. Në rastin e Shqipërisë, arsimit të lartë, sot përballet me sfiden e komercializmit të tij, c’ka do të thotë se ai është liberalizuar, jo vetëm në kuptimin e sektorit publik që e ofron atë si një shërbim, por edhe në kuptimin e sektorit privat, i cili në kaudër të një ekonomie tregu, ka të drejtë të ofrojë arsimin si një shërbim, dhe të jetë konkurrues në këtë treg.

Nga një e drejtë që i takonte vetëm një shtrese “elitare”, tashmë në këtë 10 vjecar të fundit, ai po karakterizohet nga masivizimi, i cili nënkupton jo vetëm numrin e madh të studenteve të cilët studiojnë në universitet publike, por edhe hapjen dhe funksionimin e institucioneve të larta private. Kështu, aktualisht numërohen 13 IAL publike dhe 46 IAL private. Në keto IAL në vitin akademik 2011-2012 studiojnë: 95890 studentë në IAL publike dhe 34037 studentë në IAL private. Sic shikohet edhe nga shifrat, ka një raport të zhdrejtë midis numrit të studenteve që studiojnë në IAL publike në krahasim me ato private, por realiteti flet për një numër të konsiderueshëm IAL private. Ndodhur përballë një fenomeni të tillë, me të drejtë shtrohet pyetja, pse kaq shumë IAL private, në raport me IAL publike, vecanarisht në një vend të vogël dhe me një popullsi të vogël, rreth 3 milion banorë? Ndër arsytet me kryesore mund të përmendim:

- 1- Së pari, nuk ka një strategji të qartë të qeverive shqiptare, në lidhje me arsimin e lartë privat, liberalizimi i tij vecanarisht pas viteve 2004 është bërë pa pasur këtë strategji.
- 2- Së dyti, e drejta për të vazhduar studimet në universitet publike shqiptare, vazhdon të kushtëzohet nga sistemi i kuotave që qeveria miraton çdo vit, për çdo universitet dhe në çdo program studimi.
- 3- Së treti, një kategori studentesh (vecanarisht prindërit e tyre), kërkojnë kushte me të mira, që nënkupton një staf të përgatitur, një infrastrukturë bashkëkohore, dhe një përkushtim për mësimdhënie, me profesorë të motivuar, ku këta të fundit janë të mirëpaguar në universitetet private, sesa në ato publike.
- 4- Së katërti, IAL private ofrojnë orë mësimore fleksibile. Me qëllim të tërheqjes së studentëve të punësuar, të cilët mund t’ia lejojnë vetes një edukim më të shtrëngtë, shumica e institucioneve private të arsimit të lartë janë duke ofruar mënyra fleksibile të studimeve, si nga leksionet e mbrëmjes, dita e shtunë, e deri tek opsionet fleksibile për provime.

5- Se pesti, paisja me diplomë. Shqipëria është një vend me një shkallë të lartë papunësie, (sipas të dhënave zyrtare, shkalla e papunësisë për vitin 2011 është 13.5 %, por kjo nuk është shifra reale) (Statistical Institute of the Republic of Albania (INSTAT)), kjo dikton, që për një vend pune të ketë shumë kërkesa. Si rezultat, kriteret për çdo vend pune rriten. Diploma universitare bëhet parakusht për pothuajse çdo vend pune. Në këto situata, njerëzit shikojnë vetëm si të arrijnë tek diploma, si garanci për punë.

6- Se gjashti, papunësia. Për shkak të shkallës së lartë të papunësisë në Shqipëri me tendencë në rritje, një numër i madh i popullsisë së re, i shtohet tregut të punës për çdo vit. Rritja aktuale ekonomike e Shqipërisë nuk ka kapacitete për absorbimin e këtyre personave që hyjnë në tregun e punës çdo vit. Kur një maturant i diplomuar, shikon perspektivën, ai ndodhet përballë dy alternativave:

a- të kërkojë punë me shpeshë që do ta gjejë një të tilla, apo

b- të vazhdojë arsimin universitar me shpeshë që diploma do t'i rrisë mundësitë për punësim.

Aktualisht, zgjedhja e parë është një mundësi shumë e kufizuar, dhe vetëm pak persona mund ta kenë këtë "fat". Kështu, zgjidhja e dytë, bëhet primare, dhe gjithnjë e më shumë njerëzit i drejtohen opsionit të dytë.

2- Situata në Vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Roli i Sektorit Privat të Arsimit të Lartë Vendet e Europës Juglindore (Shqipërisë, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Malit të Zi, dhe shtetit të ri Kosovës), mund të thuhet se paraqesin të njëjtën situatë në arsimin e lartë: masivizim të tij, jo cilësor, dhe të kompromentuar në sytë e opinionit publik. Këto vende, sipas një Dokumenti - Working Paper of World Bank - "From Fragmentation to Cooperation: Tertiary Education, Research and Development in South Eastern Europe", (World Bank of Albania. Publication, 2008) hasin pengesa të mëdha ndërsa përpiqen për të rritur numrin e të diplomuarve me arsim të lartë në një periudhë afatmesme, sepse:

1- Së pari, numri i nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm dhe me pas arsimin e lartë, është relativisht i ulët.

2- Së dyti, ka një rritje të konsiderueshme të numrit të nxënësve që regjistrohen në institucione private, kjo e diktuar nga fakti që arsimi i lartë, dikur ishte një arsim elitar, dhe jo të gjithë kishin të drejtë të studionin në të, por pavarësisht këtij fenomeni hapja e institucioneve private nuk e ka kompesuar numrin e ulët të të diplomuarve nga IAL publike, për një periudhë gati 40 vjecare, të sundimit të regjimit komunist.

Gjithashtu sipas këtij dokumenti: "Jo vetëm që sistemet e arsimit të lartë (...) nuk sigurojnë numrin e kënaqshëm të të diplomuarve të kualifikuar, por studentëve që mbarojnë arsimin e lartë u mungon formimi që të kontribuojnë për aftësinë kokurruese të vendeve të tyre përkatëse, me anë të asimilimit të njohurive dhe novacionit."

Vendet e Ballkanit Perëndimor, mund të klasifikohen në dy grupe:

a- vende që janë të hapura ndaj arsimit privat, ku ka një numër të konsiderueshëm të të regjistruarve;

b- vende që nuk janë të hapura ndaj arsimit privat, ku numri i të regjistruarve është i vogël.

Në grupin e parë, bëjnë pjesë Maqedonia dhe Kosova ([institutigap.org/.../Pasqyre\\_e\\_Arsimit\\_C3AB\\_Lart](http://institutigap.org/.../Pasqyre_e_Arsimit_C3AB_Lart)).

Në grupin e dytë, bëjnë pjesë Shqipëria, Mali i Zi, Kroacia, Sllovenia dhe Bosnje-

Hercegovina. Kjo ndarje bazohet:

- 1- Ne predominancën e arsimit publik. Pavaresisht se IAL privat janë të konsiderueshme në numër në shtetet e të dy grupeve, studentet nuk i drejtohen atyre, prirja vazhdon të ngelet, arsimit publik. Numri i pergjithëshëm i të të regjistruarve në arsimin e lartë, vazhdon të jete ai publik, sic është dhe rasti i Shqipërisë
- 2- Pagimi i një takse vjetore studentore të ulët në universitet publike e krahasueshme me atë të universiteteve private ( Shqiperi, Mal i Zi, Kosove), sjell përsëri preferencën e universiteteve publike.

Por pavarësisht predominancës së arsimit të lartë publik, në këto vende arsim privat po shoqërohet edhe me impaktin e tij pozitiv, i cili mund të fokusohet në këto drejtime:

- 1- IAL private kanë kontribuar për përmbushjen e kërkesës së ndrydhur për të kryer studime të larta, kërkesë kjo që ka qenë më e theksuar te nën-grupe të ndryshme të popullsisë.
- 2- IAL private, po japin kontributin më të madh duke nxitur larminë e institucioneve të arsimit të lartë. Kjo larmi do të ndihmonte të sfidohej ideja se ekziston vetëm një lloj institucioni i arsimit të lartë, d.m.th., një institucion që ofron një gamë të plotë lëndësh dhe kombinon mësimdhënien me kërkimin shkencor. Ne Strategjine Kombetare të Arsimit të Lartë, theksohet nevoja e diferencimit të misionit të IAL. Në këtë kontekst, një mision i diferencuar, do të lejoje IAL private, që ato të jenë të pozicionura, dhe të realizojnë misionin dhe objektivat e tyre.
- 3- IAL private, te cilat duan të krijojnë një fizionomi të tyre dhe duan të jenë konkurrese në tregun e arsimit të lartë, pa dyshim do të kërkojnë që sistemi i sigurimit të cilësisë, të bëjë diferencime, në funksion të prioritetit, sa më shumë studentë të regjistruar. Në këtë mënyrë, ato do të bëjnë të mundur një sistem sigurimi cilësor, funksional dhe eficient.
- 4- Impakti i tyre pozitiv, duket edhe në drejtim të rritjes së të ardhurave për personelin akademik që punon në to, vecanërisht për pedagogët e institucioneve publike. Ky punësim i dyfishtë, sjell edhe një përfitim të dyfishtë, nga njëra anë pedagogët rrisin në mënyrë të ndjeshme përfitimet e tyre, mbi pagën shtetërore, e cila vazhdon të jetë e ulët, dhe nga ana tjetre, edhe institucionet private, për shkak të nivelit të mësimdhënies që ofrohet (pedagoge me emër dhe reputacion), arrijnë të thithin më shumë student, duke rritur ndjeshëm numrin e tyre.

Parë në aspektin pozitiv, roli i arsimit të lartë, dhe vecanërisht ai i sektorit privat në këto vendë synon që të kontribuojnë për rritjen ekonomike të tyre në mënyra të ndryshme.

- 1- *Së pari*, arsimit i lartë u siguron ekonomive njerëz të diplomuar,
- 2- *Së dyti*, arsimit i lartë krijon dije të reja nëpërmjet kërkimit dhe novacionit, dhe
- 3- *Së fundi*, arsimit kontribuon për transferimin dhe asimilimin e dijeve ekzistuese, gjë që ka rëndësi të veçantë për vendet e Europës Juglindore.

Mbi të gjitha, arsimit i lartë do të luaj një rol shumë të rëndësishëm në krijimin e shoqërive moderne dhe demokratike, duke transmetuar vlerat, mbi të cilat ndërtohen shoqëritë demokratike, vecanërisht në këto vende të cilat vijnë nga një e kaluar e hidhur “komuniste”. Nga ana tjetër, liberalizimi i arsimit të lartë, do të bëjë të mundur që në kuadrin e strategjisë së

tyre konkurruese, kompanitë më të suksesshme të rajonit të kërkojnë punonjës me kualifikim të lartë, sidomos me arsim të lartë.

### **3- Mekanizmat e Kontrollit të Cilësisë dhe Roli i Tyre: Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të lartë**

Cilësia është një koncept i paqartë dhe gjithashtu një term i rëndësishëm: ajo shoqërohet subjektivisht me çfarë është e mirë dhe e vlefshme. Kjo rezultoi në koncepte të ndryshme të cilësisë në arsimin e lartë. Sa më poshtë janë përkufizime të cilësisë në arsimin e lartë (Harvey dhe Green, 1993).

**1- Cilësia si ekselencë:** Koncepti tradicional i cilësisë shoqërohet me nocionin e ofrimit të një produkti ose shërbimi që është i dallueshëm dhe i veçantë, dhe që i jep status pronarit ose përdoruesit. Cilësia është një formë ekselence duke iu referuar karakterit ekskluziv dhe të diferencuar.

**2- Cilësia si perfeksion ( zero humbje):** Nocioni i cilësisë si përputhshmëri me një specifikim ose standard. Kjo qasje e ka origjinën në nocionet e kontrollit të cilësisë në industrinë prodhuese. Ajo është bazë për matje, një term neutral për të përshkruar një karakteristikë të nevojshme të një produkti ose shërbimi.

**3- Cilësia si përshtatshmëri për qëllimin:** Përkufizimi i cilësisë i bërë nga shumica e analistëve dhe politikëbërësve në arsimin e lartë është ai i përshtatshmërisë ndaj qëllimit. Ekspozentët e kësaj qasjeje argumentojnë se cilësia nuk ka asnjë domethënie, përveçse në lidhje me qëllimin e produktit të shërbimit. Cilësia gjykohet për shkallën në të cilën një produkt ose shërbim përmbush qëllimin (et) e deklaruar (a).

**4- Cilësia si vlerë për para:** Cilësia si efektivitet në arritjen e objektivave institucionale. Ky është një variacion mbi përshtatshmërinë për modelin e qëllimit, fokusohet më shumë në përdorimin efektiv të inputeve.

**5- Cilësia si transformim:** Pikëpamja transformative e cilësisë bazohet në nocionin e ndryshimit cilësor, një ndryshim rrënjësor i formës. Transformimi nuk kufizohet në transformimin e dukshëm ose fizik por përfshin edhe një shtrirje tej sferës kognitive. Në kontekstin arsimor, transformimi i referohet përmirësimit dhe fuqizimit të studentëve ose zhvillimit të njohurive të reja.

Ndaj sigurimit të cilësisë, mbahen qëndrime të ndryshme, që ndryshojnë, veçanërisht, mes Shteteve të Bashkuara dhe vendeve të Europës (qëndrimet e të cilave ndryshojnë nga njëri-tjetri). Disa vende, e drejtojnë vëmendjen e akreditimit në nivelin e programit (p.sh.: Gjermania, ku zhvillohet një diskutim i vazhdueshëm për probleme që lidhen me këtë qasje, përfshirë procedurat tejet burokratike), vende të tjera kanë kaluar drejt akreditimeve institucionale (p.sh.: Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara).

Shëmbulli, më i mirë mund të konsiderohet Irlanda. Në Irlandë është bërë një reformë e rëndësishme, si rezultat i të cilës sigurimi i cilësisë nga mekanizma të jashtëm, deri në njëfarë mase, organizohet nga vetë institucionet e arsimit të lartë. Irlanda ka përqaftuar “qasjen e

përshtatshmërisë së qëllimit”, sipas të cilës kontrolli përqendrohet kryesisht te mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë brendapërbrenda vetë institucioneve. Këto ndryshime bazohen te përvoja në vite lidhur me sistemet e jashtme të sigurimit të cilësisë dhe, për këtë arsye, duhet të merren parasysh kur diskutohet për sigurimin e cilësisë në Europën Juglindore.

Në fakt, vendet e Europës Juglindore përballen me një sfidë të rëndësishme, e cila ka të bëjë me ngritjen e sistemeve të efektshme të jashtme të sigurimit të cilësisë në shkallë kombëtare. Për shkak të dimensionit të tyre të vogël, ato nuk arrijnë të trajtojnë një numër çështjesh që lidhen me sigurimin e cilësisë nga jashtë sistemit, përfshirë organizimin e analizave të pavarura nga ana e homologëve në shkallë kombëtare.

Shoqata e Universiteteve Europiane, në Raportin e saj vjetor të publikuar ka vënë në dukje se këto çështje duhet të trajtohen edhe në nivel rajonal. Nga ana tjetër, Komunikata e Berlinit, e cila u miratua nga takimi i Ministrave të vendeve nënshkruese të Procesit Bolonjës në vitin 2003, thekson se vetë universitetet duhet të mbajnë përgjegjësinë kryesore për sigurimin e cilësisë. Por, ajo që karakterizon sot vendet e Evropës Juglindore, është se ato nuk i kanë kushtuar vëmendje e duhur krijimit të mekanizmave të shëndoshë të brendshëm të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë. Po ashtu, në Evropën Juglindore, nuk ka patur as debat informativ për balancimin e mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm të sigurimit të cilësisë.

Zhvillimet e tanishme në Europë mund të paraqesin probleme të veçanta për vendet e Europës Juglindore lidhur me sigurimin e cilësisë. Kijimi i një regjistëri të agjencive europiane të sigurimit të cilësisë, ka bërë që këto vende të gjenden nën presion, gjithnjë e më të madh, që të përdorin agjencitë e kësaj liste. (Komisioni European mbështet idenë se, për të përmbushur detyrimet kombëtare për sigurimin e cilësisë, një vend mund të përdorë çdonjërin nga organet të sigurimit të cilësisë që figuron në këtë regjistrë). Por, vetë madhësia e vendeve të Europës Juglindore krijon shqetësime nëse vendet e Evropës Juglindore do të arrijnë të regjistrojnë agjencitë e tyre kombëtare. Gjithashtu, këto agjenci kanë vështirë të konkurrojnë në “tregun” në zhvillim e sipër të Europës përsa i përket sigurimit të cilësisë.

#### **4- Si Paraqitet Situata në Shqipëri ?**

Sigurimi i cilësisë nga jashtë institucioneve arsimore, i cili lidhet me njohjen e diplomave dhe programeve, erdhi si kërkesë e Procesit të Bolonjës, në të cilën Shqipëri u bë pjesë që nga viti 2003. Ajo që pa karakterizon mekanizmin e jashtëm të sigurimit të cilësisë në Shqipëri, Agjencine Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) është fakti se ajo është krijuar si një mekanizëm i ngurtë, pa një autonomi institucionale, pa deklarate të misionit të saj dhe nuk ka një strategji, e cila të percaktojë qartë objektivat e saj për një periudhë 3- 5 vite në vazhdim (Timms; 2011).

Brenda saj, funksionon Keshilli i Akreditimit, i cili është organi vendimarrës në drejtim të procedurave të vlerësimit dhe të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit. Sot pozicioni i tij, detemionon veprimtarinë e APAAL, pasi akti nenligjor VKM nr. 368, datë 14.04.2011 “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, të ndryshuar i ka dhënë atij një fuqi mbi agjencinë (VKM nr. 368, 2011). E rëndësishme është që agjencia të kthehet në

nje mekanizem eficient. Duke pasur sipas “Standards and Guidelines for Quality Assurance In the European Higher Education Area” një:

- 1- Status zyrtar,
- 2- Resources/Burimet e saj,
- 3- Misionin,
- 4- Pavarësine,
- 5- Kriteret e jashtëm të cilësisë dhe proceset e përdorura nga Agjencia,
- 6- Procedure te llogaridhënies ( Helsinki 2009).

Për shkak të dimensionit të vogël të APAAL, si dhe të influencave të ndryshme mbi të, ajo nuk ka arritur të trajtojë një numër çështjesh që lidhen me sigurimin e cilësisë nga jashtë sistemit, përfshirë organizimin e analizave të pavarura nga ana e homologëve në shkallë kombëtare. Po ashtu, edhe mekanizmi i brendshëm i kontrollit të cilësisë, i cili u miratua nga takimi i Ministrave të vendeve nënshkruese të Procesit Bolonjës në vitin 2003, në Komunikatën e Berlinit, thekson se vetë universitetet duhet të mbajnë përgjegjësinë kryesore për sigurimin e cilësisë. Sidoqoftë, deri më sot, IAL-të si publike ashtu dhe private nuk i kanë kushtuar vëmendjen e duhur krijimit dhe funksionimit të këtij mekanizmi. Ai nuk është bërë një kulturë institucionale e IAL-ve.

Pavaresisht se standardet shtetërore të cilësisë, miratuar edhe me një sere aktesh të mëparshme nënligjore (UMASH, nr. 136, 2011) , që i referohen përkatesisht nivelit të programeve të studimit, vënë me të madhe theksin mbi të, ai ngelet sot, si një mekanizem i pasqyruar vetem në dokumentacionin që paraqesin IAL, për licensim pranë MASH, por jo një mekanizem funksional.

Nga ana tjetër, mungon një debat informativ për balancimin e mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm të sigurimit të cilësisë.

### **5- Kuadri Ligjor Shqiptar në Fushën e Arsimit të Lartë Privat**

Ligji nr. Nr.9741, datë 21.5.2007 “Per arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” (Ligji nr. Nr.9741, 2007), ndryshuar, është akti ligjor kryesor që rregullon marrëdhëniet në drejtim të krijimit, organizimit, funksionimit, administrimit, financimit, dhe sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, qofshin ato publike apo private. Pjesëmarrja e Shqipërisë, në procesin e Bolonjes (2003) (MASH,2012), si dhe nënshkrimi Marreveshjes së Stabilizimit Asocimit me shtetet anëtare të BE-se (2006), ka diktuar përpara qeverisë shqiptare, që arsimit i lartë duhet të shkojë në qasje me standardet europiane të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë. Në këtë kontekst, ligji sanksionon se misioni i tij është (Ligji nr. 9741, 2007):

- 1- të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve; të zhvillojë dhe të çojë përpara artet, edukimin fizik dhe sportet; të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj;
- 2- të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimit i lartë gjatë të gjithë jetës;
- 3- të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal;
- 4- të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.

Arsimi i lartë, sipas dispozitave të këtij ligji ushtrohet nga IAL, që janë persona juridikë,

publikë ose privatë, të organizuara në formën e universitetit, akademisë, kolegjit profesional, shkollës së lartë dhe qendrës ndëruniversitare (Ligji nr. 9741, 2007). Te drejtën për të qenë “universitet”, e ka vetëm ai IAL, i cili ofron programe studimi në tre ciklet, bachelor, master, doktoraturë, dhe ka në përbërje, së paku, dy fakultete, dhe përfaqëson një strukturë, të përbërë dhe të integruar, që realizon arsimim të lartë, zhvillim të dijeve, shkencës, profesioneve dhe transmeton njohuri në fusha dhe disiplina shkencore dhe profesionale (Ligji nr. 9741, 2007). Aktualisht statusin e Universitetit, e kanë 11 IAL publik dhe 3 IAL private (Ligji nr. 9741, 2007). Në rast se shikohet tabloja e arsimit të lartë dhe vecanarisht atij privat, pjesa me e madhe e institucioneve private, kanë vetëm statusin e IAL-ve ose të akademive.

Sipas ligjit, “Institucione të arsimit të lartë”, janë ato pesona juridike që ofrojnë arsimim të lartë në ciklin e parë ose/ edhe të dytë të studimeve. Ato ngrihen dhe funksionojnë edhe me, së paku, dy fakultete. Ato mund të ofrojnë kërkim shkencor të aplikuar dhe shërbime në fushat përkatëse, në përputhje me statutin e tyre (Ligji nr. 9741, 2007).

“Akademi”, quhen ato IAL që mund të ofrojnë programe të studimeve për të tre ciklet dhe kanë në përbërje, së paku, dy fakultete. Akademitë ofrojnë arsimim të lartë profesional dhe veprimtari krijuese në fusha specifike të artit, sportit, të sigurisë dhe të mbrojtjes, e fusha të tjera profesionale, si edhe në kërkim shkencor në fushat përkatëse, në varësi të ciklit të studimit, në përputhje me statutet e tyre (Ligji nr. 9741, 2007).

Ne kreun e 6-te ligjit të titulluar « Arsimi i lartë privat », vetëm në 4 nene (Ligji nr. 9741, 2007) rregullohen çështjet, në lidhje me: natyrën e institucionit privat të arsimit të lartë; licencimin e një institucioni privat të arsimit të lartë; hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimeve të cikleve të arsimit të lartë privat, si dhe organizimin e studimeve në institucionet private të arsimit të lartë. Sipas ligjit shqiptar për arsimin e lartë, të drejtën për të kërkuar licensimin e një IAL private, e ka çdo subjekt juridik, si vendas ashtu dhe i huaj. Subjekti që kërkon të hapë një institucion privat të arsimit të lartë, paraqet projektin e tij pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, sipas kriterëve të vendosura në një udhezimin (Ligji nr. 9741, 2007) të posaçëm të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Dokumentacioni i paraqitur, duhet të përcaktojë qartë misionin, objektivat afatgjata të institucionit, programet e studimeve, si dhe skema e financimit. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, kur shikon se kërkesa është në përputhje me kriteret ligjore, shprehet me vendim të argumentuar për projektin e paraqitur, mbështetur në vlerësimin e Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, i cili vepron pranë Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë. Më pas është vetë Këshilli i Ministrave, ai i cili jep vendim për dhënien e licencës, e cila bëhet e vlefshme me miratim që jep me pas Ministri i Arsimit për fillimin e viti akademik. E njëjta procedure, ndiqet edhe në rastin, e një institucion privat, që zotëron një formë akreditimi nga një shtet tjetër. Ai është i detyruar të paraqesë një certifikatë për këtë akreditim në Këshillin e Akreditimit, i cili bën vlerësimin e tij në përputhje me licencën e kërkuar.

Në lidhje me hapjen, mbylljen dhe riorganizim e programeve të studimeve të cikleve të arsimit të lartë privat, kërkesa e subjektit të interesuar, e cila shoqërohet nga projekti që përmban misionin, objektivat afatgjatë të institucionit, programet e studimeve, skemën e financimit, pasi vlerësohet nga Këshilli i Akreditimit, i kalon për miratim Ministrit të Arsimit, i cili në këtë rast, vetëm ai ka kompetencën ekskluzive të miratimit ose të refuzimit të



kërkesës.

Pavarësisht se ne pamje të parë, gjithëcka duket e rregull, shihet qartë, se ligji sanksionon një parregullsi, kur ai pranon që “te drejtën për të kërkuar licensimin e nje IAL private, e ka cdo subjekt juridik, si vendas ashtu dhe i huaj”.

Në parim, cdo IAL krijohet si një shoqëri tregëtare, në bazë të dipozitive të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ose si një OJF, sipas ligjit nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimpruese”, ndryshuar dhe pasi fiton personalitetin juridik, e para nëpërmjet regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe të dytat pranë Gjykatave të Rretheve, kanë të drejtë të aplikojnë për tu licensuar si IAL.

Nuk ka një ligj të posacëm, që të rregulloj mënyrën e krijimit dhe të funksionimit të këtyre IAL-ve private, si persona juridik.

Në realitetin shqipar, ato janë krijuar në formën e një Shoqërie kapitali (SHPK, SHA), dhe vepronë dhe i nënshtrohen rregullave të shoqërisë tregëtare, pavarësisht se ato kryejnë edhe funksionin e një IAL.

Çka ofrojnë institucionet e arsimit të lartë privat sot, në Shqipëri. Arsimi i lartë privat, sot në Shqipëri është i fokusuar më së shumti në katër drejtime kryesore (Development of a Ranking in Albania, July 2011):

- 1- Drejtësi
- 2- Ekonomik
- 3- Infermieri
- 4- Shkenca shoqërore (Mësuesi)

Bazuar në kornizën ligjore të standarteve shtetërore të cilësisë, miratuar me Udhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 126, datë 17.03.2011 “Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin institucional të institucioneve të arsimit të lartë (UMASH, 2011)”, mund të shikojmë se si paraqitet gjendja e IAL private sot në Shqipëri, e fokusuar në tre drejtimet kryesore të këtyre standardeve institucionale:

1. Programet e studimit;
2. Kërkimi shkencor;
3. Menaxhimi institucional .

#### *a- Programi i Studimit*

Programi i studimit, sipas kërkesave të standarteve duhet të përmbajë një sërë kriteresh, ai duhet të jetë: në përputhje me ciklin e studimit që do të ofrojë IAL; forma e studimit duhet të jetë e përshtatshme për këtë Program Studimi; misioni dhe objektivat e tij duhet të jenë të tilla që të japin dije, aftësi dhe kompetenca të përshtatshme; ai duhet të shoqërohet edhe nga një studim real tregu, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar dhe cili është tregu potencial i punës për të diplomuarit në këtë Program Studimi , etj ceshtje. Referuar atyre c’ka paraqesin sot programet e studimt, te IAL private, mund të thuhet se kërkesat që kërkon MASH si dhe APAAL, dhe KA që vepron pranë saj, janë të shkruara në

mënyrë të qartë, por ato ngelen deri aty, realiteti flet jo gjithmonë bazuar në ato që shkruhen. Programe studimi të fakulteteve të ndryshme të IAL private nuk ndryshojnë aq shumë nga njeri institucion tek tjetri. Pjesa me dermuese e IAL, që operojnë në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë ofrojnë Programe Studimi në drejtësi dhe ekonomik. Nga ana tjetër, shumë pak prej tyre (nuk ka të dhëna zyrtare), që operojnë në Tiranë, nuk i kanë publikuar këto programe në ëeb-faqet e tyre. Për shkak të mungesës së përvojës dhe traditës, programet e studimit kanë prirjen e kopjimit të atyre të vendeve zhvilluara. Ky kopjim pa përshtatjen e duhur, në funksion të situatave dhe nevojave konkrete ka rezultuar i papërshtatshëm dhe shpesh konfuz, ku dihet që synohen t'u ofrohen studentëve ose kanë qenë të mbingarkuara ose të mangëta dhe, nga ana tjetër, vetë IAL -ve i është dashur të marrin përsipër edhe një kosto financiare të konsiderueshme.

#### *b-Kërkimi Shkencor*

Bazuar në këtë drejtim të rëndësishëm të standarteve institucionale, mund të thuhet se IAL-te private, janë shumë larg të qenit të kësaj kërkese të rëndësishme bashkëkohore, një nga shtyllat e të qenit shkollë e lartë (që sic dimë bazohet në dy shtylla të mëdha mësimdhënie dhe kërkim shkencor). Aktualisht me një numer të vogël personeli akademik, i cili në të shumtën e rasteve është i jashtëm, me një numer të vogël studentesh, pa veprimin e mekanizmave adekuate përberese, sic janë departamentet apo qendrat kërkimore, ato nuk mund të ndërmarrin ndonjë veprimtari kërkimore-shkencore. Pra në të shumtën e rasteve roli i tyre është thjeshtë dhe vetëm mësidhënës.

Duke qenë në një madhësi të vogël, sesa institucionet publike në Shqipëri, ato rrallëherë ofrojnë diploma për punë kërkimore dhe, zakonisht, janë të përqendruara në një gamë më të ngushtë lëndësh dhe programesh.

Asnjë veprimtari nuk ndërmeret nga ato për të kualifikuar stafin e brendshëm (me ndonjë përjashtim të rrallë). Edhe lehtësirat fiskale, që u ndërmoren nga qeveria nëpërmjet amendimit të Ligjit Nr. 7928 date 27.04. 1995 "Mbi TVSH," nëpërmjet Ligjit Nr. 10215 datë 21.01. 2010 duke ju hequr atyre pagimin e TVSH në lidhje me tarifën studentore, me qëllim që ky fond, të shkonte në drejtim të infrastrukturës dhe të kërkimit shkencor, aktualisht nuk funksionojë kështu.

#### *c- Menaxhimi Institucional*

Bazuar në këtë drejtim, standartet që e përbëjnë menaxhimin institucional janë: Autonomia; Organizimi i institucioneve të arsimit të lartë; Partneriteti; Menaxhimi i burimeve njëzëzore; Menaxhimi i veprimtarisë së institucionit; Menaxhimi financiar; Menaxhimi i sistemeve të informacionit.

Duke parë realitetin, mund të thuhet se këto standarte për IAL-të private, të cilat në të shumtën e rasteve janë shoqëri tregëtare, që drejtohen dhe administrohen nga vetë pronarët e tyre, ngelen të shkruara vetëm në statutet dhe rregulloret e tyre, se janë vetë ortakët ose aksionerët që drejtojnë dhe administrojnë IAL-te private.

### **6-Çfarë duhet bërë?**

Ndodhur përballë komercializmit të arsimit të lartë, e rëndësishme sot është që të bëjmë një ristrukturim të organizimit të universiteteve tona si publike ashtu dhe atyre private. Kështu, skema e re e financimit e propozuar nga MASH, në "Dokumentin e Gjelbër" (Green Paper,

2010), synon të garantojë që sistemi i financimit publik, të ofrojë stimuj që këto institucione të përmbushin misionet e tyre përkatëse për rritjen e aftësisë konkurruese dhe të kohezionit social.

Kjo skemë, kërkon kalimin, gjithnjë e më shumë, drejt sistemeve të financimit me bazë performancën. Për shembull, subvencionet publike për taksat e universiteteve duhet të synojnë që studentët me të ardhura të pamjaftueshme, në një periudhë më afatgjatë, të lidhen me sistemet që ofrojnë kredi për studentët.

Sistemet e arsimit të lartë në vendet e Evropës Juglindore janë të pabalancuara. Kështu, përshembull Universiteti i Tiranës, dominon gjithë sistemin përsa i përket numrit të regjistrimeve dhe burimeve. Sfida në një periudhë afatmesme është që të krijohet një numër i kënaqshëm universitetesh efektive dhe me programe të plota mësimore. Në një periudhë më afatgjatë, duhet të krijohen sisteme të arsimit të lartë, që të jenë më të balancuara dhe që përmbushin nevoja të ndryshme, si dhe specializimin e institucioneve të arsimit të lartë. Duhet t'i kushtohet vëmendje reformimit të sistemit të sigurimit të cilësisë me qëllim që të vendoset ekuilibri i duhur mes llogaridhënies dhe autonomisë. Nuk ka ndonjë “recetë” të caktuar, në lidhje me rolin e institucioneve private. Sektori privat po jep kontributin e tij duke nxitur larminë e institucioneve të arsimit të lartë. Ky rezultat kërkon që sistemet kombëtare të sigurimit të cilësisë dhe, veçanërisht, të akreditimit të mbështesin larminë institucionale. Forcimi i lidhjeve mes universiteteve dhe sipërmarrjeve private duhet të përbëjë prioritetin të rëndësishëm përsa i përket kërkimit dhe zhvillimit, duke patur parasysh se kontributi më i madh që mund t'i japë një sektor kërkimor vendit është që të ndihmojë kompanitë të përvetësojnë dhe të përshtasin ide dhe teknologji të reja nga vende të tjera.

Njëkohësisht, duhet të rriten në mënyrë të konsiderueshme financimet private për nevoja të kërkimit dhe zhvillimit, si dhe punësimi i punonjësve shkencorë në sektorin privat.

## **7-Konkluzion**

Arsimimi i lartë në Shqipëri, dhe vecanarisht ai privat gjendet në një situatë kritike përballë këtij masivizimi pa kriter dhe pa një startegji zhvillimit të qartë dhe me objektiva afatmesme dhe afatgjata. Mekanizmi i jashtëm i kontrollit të cilësisë, APAAL vazhdon të jetë një mekanizem i ngurtë. Duke mos pasur një deklaratë të misionit të tij dhe një autonomi nga MASH, ai nuk mund të realizojë në mënyrë të pavaruar dhe transparente procedurat vleresuese dhe akredituese, si dhe nuk mund të bëhet pjesë e ENQA-s si dhe të sigurojë regjistrimin e tij në Regjistrin Europian. Mungesa e larmisë së Programeve të Studimit, dhe fokusimi i tyre vetëm në katër fusha (drejtësi, ekonomik, mësuesi dhe infermjeri), nuk mund të jenë në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit, i cili kërkon në të njëjtën kohë një zhvillim industrial, teknologjik, bujqësor, dhe shkencor. Mungesa e një autonomie institucionale dhe finaciare, nuk mund të krijojë institucione të besueshme, dhe kredibile si për studentet ashtu dhe përballë opinionit publik. Standardet shtetërore të cilësisë, duhet të bëhen korniza ligjore detyruese për të gjithë IAL private të cilat duan të sigurojnë ekzisten e tyre në tregun e arsimit të lartë, por edhe të jenë konkurruese midis tyre dhe me ato të publiket. Sidoqoftë, institucionet private mund të modernizohen në një sërë mënyrash, për shembull, duke përfshirë modalitete të reja të aksesit dhe ofrimit të arsimit, dhe duke ju përshatur nevojave të zhvillimit ekonomik të vendit.

## Referenca

Agjensia Publike e Akreditimit te Arsimit te Larte, available at [www.apaal.gov.al](http://www.apaal.gov.al), Accessed 15.02.2012

Arsimit të Lartë Privat në Kosove (Analizë). available at [institutigap.org/.../Pasqyre\\_e\\_Arsimit\\_C3AB\\_Lart](http://institutigap.org/.../Pasqyre_e_Arsimit_C3AB_Lart), Accessed 15.02.2012

David Timms (2011 ), Support to APAAL to ensure it matches up to international standards development, Review Report, APAAL

Development of a Ranking in Albania. Final Report, (2011), available at [www.apaal.gov.al](http://www.apaal.gov.al) Accessed on July, 2012

Ligji nr. Nr.9741, datë 21.5.2007 “Per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise”, Official Gazette of the Republic of Albania, no. .68/2007 and Official Gazette no.111/2010

Ministria e Arsimit dhe Shkences se Republikes se Shqiperise, [www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al), Accessed 15.02.2012

Nenet 43, 44, 44/1,45, Ligji nr. 9741, date 21.5.2007 “Per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise”

Neni 2 i Ligji nr. 9741, date 21.5.2007 “Per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise”, ndryshuar.  
Neni 4 i Ligji nr. 9741, date 21.5.2007 “Per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise”, ndryshuar  
Neni 5, pika 1 dhe 4, Ligji nr. 9741, date 21.5.2007 “Per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise”, ndryshuar

Neni 6, pika 1, Ligji nr. 9741, date 21.5.2007 “Per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise”, ndryshuar

Neni 6, pika 2, Ligji nr. 9741, date 21.5.2007 “Per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise”, ndryshuar.

Standards and Guidelines for Quality Assurance In the European Higher Education Area. 3rd edition, Helsinki 2009.

Udherin e Ministrit te Arsimit dhe Shkences nr. 126, date 17.03.2011

Urdhri i Ministrit te Arsimit dhe Shkences nr. 134, date 21.03.2011

Urdhri i Ministrit te Arsimit dhe Shkences nr. 135, date 21.02.2011 2011

Urdhri i Ministrit te Arsimit dhe Shkences nr. 136, date 21.02.2011

VKM nr. 368, date 14.04.2011 “Per miratimin e rregullores per sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarine e institucioneve te sigurimit te jashtem te cilesise”, ndryshuar

Working Paper of Word Bank -“From Fragmentation to Cooperation: Tertiary Education, Research and Development in South Eastern Europe”World Bank of Albania. Publication, 2008

## Intercultural Education: A theoretical Approach to Cultural Value Orientations

### Abstract

*As multiculturalism has become the matter of the day, it is not only the business world that must adopt to changes; the academic sector must also deal with the trend as well. As such, the necessity to accommodate cultural diversity has become more apparent. Education not only helps to make sense of the local culture, it offers individuals insights and skills they need to survive in the changing world. Only through multicultural education can people learn about those problems and issues that cut across ethnic, national, and gender boundaries and learn to understand how other groups process experience in ways that may differ from our own perceptions. This paper aims at highlighting some of the main models of cultural value orientations and applying them in real-life and everyday educational and teaching contexts.*

**Keywords:** *Intercultural Communication, Cultural Value Orientations, Multicultural Education*

## 1. Introduction to Intercultural Communication

Intercultural communications, regardless of its recent developments, tends to be a relatively unexplored academic field. Regarding its beginnings, it is impossible to separate its origin from the development of linguistics in the 1920s. As for its father, E. T. Hall is widely accepted as the forerunner of the field by raising such issues as “intercultural tensions” and “intercultural problems” in the 1950s (Chen & Starosta 1998: 8). In fact, Hall’s contributions extend to focusing the traditional anthropology studies on comparative culture study thus shifting from the study of culture from a “macro perspective to a micro analysis”, which allowed the study of practical needs of the interactants in communication. Hall further linked culture with communication by replacing “the emphasis from qualitative methods of anthropology to the quantitative methods of communication research”. Precisely, Hall analyses communication as a “rule-governed, analyzable, and learned variable” (Chen & Starosta 1998: 8-9).

Further works which redefined the field in the 1970s included Stewart’s *American Cultural Patterns* (1972) and Samovar & Porter’s *Intercultural Communication: A Reader* (1973), Prosser’s *Intercommunication among Nations and People* (1973), *Cultural Dialogue* (1978), Smith’s *Transracial Communication* (1973), Condon and Yousef’s *Introduction to Intercultural Education* (1975), and Asante, Blake, and Newmark’s *The Handbook of Intercultural Communication* (1979), to name a few. However, it was only in the 1980s when the field “began to move from disarray to a more coherent focus” (Chen & Starosta 1998: 10) with the publication of such works as Gudykunst’s *Intercultural Communication Theory: Current Perspectives* (1983), Gudykunst and Kim’s *Methods of Intercultural Research* (1984), and Kim and Gudykunst’s *Theories in Intercultural Communication* (1988).

## 2. Communication vs. Culture

The formal study of communication goes back to Aristotle’s *Rhetoric* of two thousand years ago. In fact, early views of human communication tended to embrace a mechanistic perspective of the communication process. Such a perspective regards communication as a unidirectional process in which the receivers are passively influenced or victimized by powerful sources. Recently, more and more scholars have treated human communication as a process in which our behaviors can be explained by referring to our intentions, reasons, and goals. In other words, we are active agents, possessing the ability to choose actions in the interactional process rather than being driven by external factors that determine our behaviors (Chen & Starosta 1998: 21). Regarding its definition communication remains “the process whereby humans collectively create and regulate their social reality” (Trenholm & Jensen 2008: 4).

As far as culture is concerned, we are programmed by our culture to do what we do and to be what we are. In other words, “culture is the software of the human mind that provides an operating environment for human behaviors” (Chen & Starosta 1998: 25). As for its definition, it consists of “learned patterns of perception, values, and behaviors, shared by a group of people, which is dynamic and heterogeneous. Culture also involves our emotions and feelings” (Martin & Nakayama 2008: 28). Like communication, culture also tends to be holistic, learned, dynamic, and pervasive (Chen & Starosta 1998: 26). In fact, successful

intercultural communication is based on three main factors: (1) the positive feeling we possess at the affective level, including information, self-esteem, comfort, trust, and safety; (2) the beliefs we bring into the intercultural encounter at the cognitive level, including expectations, stereotypes, uncertainties, and misunderstanding of rules or procedures; and (3) the action or skills we possess at the behavioral level, including verbal and nonverbal communication skills in intercultural settings.

### 3. Defining Patterns of Cultural Value Orientations

In fact, it was Kluckholm and Strodtbeck (1961) who first introduced the concept of cultural value orientations. The other most common models for the study of cultural values orientations include Condon and Yousef (1975), Hall (1976), and Hofstede (1980, 1983, 1984).

#### *Kluckhohn and Strodtbeck's Model*

Kluckhohn and Strodtbeck singled out five universal problems faced by all human societies and identified their respective cultural value orientations:

1. What is the character of human nature? (the human nature orientation)
2. What is the relationship of people to nature (and supernatural); (The man-nature orientation).
3. What is the temporal focus of human life? (the time orientation)
4. What is the modality of activity? (the activity orientation)
5. What is the modality of a person's relationship to other persons? (the relationship orientation)

Thus, Kluckhohn and Strodtbeck provided three possible variations of the solution for each problem:

#### Range of Values

Human nature:	Basically good	Mixture of good and evil	Basically evil
Relationship between Humans and Nature	Humans dominate	Harmony between the two	Nature dominates
Relationship between Humans:	Individual	Group-oriented	Collateral
Preferred Personality:	“Doing”: stress on action	“Growing”: stress on spiritual growth	“Being”: stress on who you are
Time orientation:	Future-oriented	Present-oriented	Past-oriented (quoted in Chen & Starosta 1998: 46).

In fact, the above questions and responses help us understand broad cultural differences among various cultural groups- national and ethnic groups as well as groups based on gender, class and so on.

Condon and Yousef's Model: Condon and Yousef (1975) revised and extended Kluckhohn and Strodtbeck's five categories to include six spheres of universal problems all human societies must face: the self, the family, society, human nature, nature, and the supernatural. Under each sphere the authors added three to five orientations with three variations of the solutions for each one.

## **SELF**

### *Individualism-interdependence*

1. Individualism                      2. Individuality                      3. Interdependence

#### Age

1. Youth                                      2. The middle years                      3. The old age

#### Sex

1. Equality of sexes                      2. Female superiority                      3. Male superiority

#### Activity

1. Doing                                      2. Being-in-becoming                      3. Being

## **THE FAMILY**

### *Relational orientations*

1. Individualistic                      2. Collateral                                      3. Lineal

#### Authority

1. Democratic                                      2. Authority centered                      3. Authoritarian

#### Positional role behavior

1. Open                                      2. General                                      3. Specific

#### Mobility

1. High mobility                      2. phasic mobility                      3. Low mobility, stasis

## **SOCIETY**

### *Social reciprocity*

1. Independence                      2. Symmetrical-obligatory                      3. Complementary-obligatory

### *Group membership*

1. Many groups, brief identification, subordination of group to individual                      2. Balance of nos 1 and 3                      3. Few groups, prolonged identification, subordination of the member to the group

### *Intermediaries*

1. no intermediaries (directness)                      2. specialist intermediaries only                      3. essential intermediaries

### *Formality*

1. informality                                      2. selective formality                      3. pervasive formality

### *Property*

1. private                                      2. utilitarian                                      3. community



## **HUMAN NATURE**

### *Relationship*

1. rational
2. intuitive
3. irrational

### *Good and evil*

1. good
2. mixture of good and evil
3. evil

### *Happiness, pleasure*

1. happiness as goal and sadness
2. inextricable bond of happiness
3. life is mostly sadness

### *Mutability*

1. change, growth, learning
2. some change
3. unchanging

## **NATURE**

### *Relationship of man and nature*

1. man dominating nature
2. man in harmony with nature
3. nature dominating man

### *Ways of knowing nature*

1. Abstract
2. circle of induction-deduction
3. specific

### *Structure of nature*

1. mechanistic
2. spiritual
3. organic

### *Concept of time*

1. future
2. present
3. past

## **THE SUPERNATURAL**

### *Relationship of man and the supernatural*

1. man as god
2. intellectual goals
3. man controlled by the supernatural

### *Meaning of life*

1. physical, material goals
2. intellectual goals
3. spiritual goals

### *Providence*

1. good in life is unlimited
2. balance of good and misfortune
3. good in life is limited

### *Knowledge of the cosmic order*

1. order is comprehensible
2. faith and reason
3. mysterious and

unknowable (quoted in

Chen and Starosta 1998: 49).

The following chart compares the different orientations of the Chinese and Northern Americans toward family:

<b>Family</b>	<b>China</b>	<b>United States</b>
Relational Orientation	Lineal orientation- Characterized by a highly developed historical consciousness and a close association with extended families. Wife tends to be subordinate to husband and to parents in family.	Individualistic orientation- Older and younger members of the family always share the same values. Wife and children are more equal to husband, and children must be obedient to parents.
Authority	Authority orientation- Reflects a strong orientation toward paternal authority.	Democratic orientation- Obligations are open to negotiation. The family is child-centered.
Positional role behavior	Specific orientation- Generation, age, and sex hierarchy is very strong; i.e., the older generation, elders, and male are superior.	Open orientation- Obligations are open to negotiation.
Mobility	Low-mobility orientation- The family structure and an agricultural society made the Chinese settle in a fixed place and cultivate the land in an orderly fashion.	High-mobility orientation, conjugal family structure, no kinship bondage and high degree of technology and transportation have produced a highly mobile society. (Chen & Starosta 1998: 47)

Hall's Culture Context Model: Hall (1976) divided cultural differences into two categories: low-context culture and high-context culture.

#### **Low-Context Culture**

1. Overtly displays meanings through direct communication forms.
2. Values individualism.
3. Tends to develop transitory personal relationship.
4. Emphasizes linear logic.
5. Values direct verbal interaction and is less able to read nonverbal expressions.
6. Tends to use "logic" to present ideas.
7. Tends to emphasize highly structured messages, give details, and place great stress on words and technical signs (Chen & Starosta 1998: 51).

#### **High-Context Culture**

1. Implicitly embeds meanings at different levels of the sociocultural context.
2. Values group sense.
3. Tends to take time to cultivate and establish a permanent personal relationship
4. Emphasizes spiral logic.
5. Values indirect verbal interaction and is more able to read nonverbal expressions.
6. Tends to use more "feeling" in Expression.
7. Tends to give simple, ambiguous, nonexistent messages.

Hofstede's Cultural Dimensions: Hofstede (1980, 1983, 1984) compared work related attitudes across over forty different cultures and found four consistent dimensions of cultural values: individualism/collectivism, power distance, uncertainty avoidance, and masculinity/femininity:

*Power Distance*

Low power distance

Less Hierarchy better

High power distance

More Hierarchy Better

*Feminity/Masculinity*

Femininity

Fewer gender specific-roles

Value quality of life, support for unfortunate acquisition

Masculinity

More gender-specific roles

Value achievement, ambition,

of material goods

*Uncertainty Avoidance*

Low uncertainty avoidance

Dslike rules, accept dissent  
dissent

Less formality

High uncertainty avoidance

More extensive rules, limit

More formality

*Long-Term/Short-Term Orientation*

Short-term orientation

Truth over virtue

Prefer quick results

Long-term orientation

Virtue over truth

Value perseverance and tenacity  
(Martin & Nakayama 2008: 43).

